



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 118, Gusht 2013**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## KRONIKË E VEPRIMTARIVE MË 1 GUSHT 2013, KUKEL 2

**Mentor QUKU**

Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeore "Ndre Mjeda", Komuna e Bushatit dhe Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, organizuan më 1 gusht 2013, ora 17 e 30, në fshatin Kukel, te komunes se Bushatit, takimin Folklorik Gjithënational, në kuadrin e edicionit të Tretë të "Ditëve të Mjedës". Aktiviteti u zhvillua në përkujtim të 76 vjetorit të vdekjes së Ndre Mjedës dhe 100-vjetorit të ngritjes së Kishës së Kuklit. Merrnin pjesë banorë të fshatit Kukel, Barbullush, Bushat, Grash, si edhe të rrethinave. Gjithashtu merrnin pjesë intelektualë të shquar në lamiye të ndryshme të dijes dhe jetës shoqërore, studiues, artistë, klerikë, gazetarë, përfaqësues të mediave. Kishin ardhur për të nderuar këtë veprimtari të rëndësishme personalitete, si Drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Prof. dr. Ardian Marashi, Emzot Angelo Massafra, Kryetar i Konferencës ipeshkvnore të Shqipërisë, Kryetari i Komunës së Bushatit, Konsulli i Nderit të Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqeja, si edhe të tjerë.



## 3 NDAHET NGA JETA ARTAN BUSHATI

## NË BREG TË BUBËS - THETH

(NGA BLOKU I SHËNIMEVE) 4

Sa më shumë të rritesh në moshë gjithnjë e më shumë të shtohet dëshira për vendin ku je lindur, rritur, ku ke pasur gëzime por edhe mërzitje, ku është toka që na lanë të parët e ku prehen eshtrat e tyre. "S'ka madh më të madh se malli për vendlindjen" thuhet te filmi "Udha e shkronjave". Në këto momente më vjen në mendje një bisedë e bërë me Ndue Markun nga Ndërlisa mbi 20 vjet më parë. Rastësisht, ndërsa po kthehesha nga Rragami për në Theth, pasi kisha qëndruar disa ditë te kushëriri im Fran Shyti, gjatë rrugës takohemi në Brinjën e Shkallës.

## 3 SHLLAKU THËNGJILLTAR FISI I TRIMËRISË, BESËS, TËRVESES RAKISË DHE QYMYRIT!

Shllaku një nga fiset më të mëdha, më të rëndësishëm të malësisë së Shkodrës, administrativisht herë si pjesë e Postribës, herë e Dukagjinit por etnografikisht dhe gjenalogjikisht i përket Dukagjinit. Nga llogaritja e gjenealogjive të zakonshme, Shllaku rrjedhë nga Vasojeviqët ose nga Toplana se, nga Vasejoviqet...

## Aroma e Verës në Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini"

Në kuadrin e 10 vjetorit të themelimit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe të punës që po bëjmë me afrimin e të rinjve dhe të reja në gjirin e shoqatës, gjatë muajve Korrik-Gusht 2013, kemi organizuar disa veprimtari, ne te cilat vendin kryesor e kanë zënë të rinjtë dhe të rejat, të cilët janë ndierë mirë dhe pasi janë njohur edhe më nga afër me shoqatën, ata shprehen të lumtur dhe krenar që tashmë janë pjesë e saj. Duke marrë mendimet e tyre ne e ndjejmë vetët edhe më të mirë dhe më të guximshëm për të ardhmen. Te punosh më 6 dhe të rejat do të thotë të punosh për të ardhmen që ajo të jetë më e mirë.

## 9 Një vepër e re e akademikut Aleksandër Stipçević për Arbëneshin (Arbanas) e Zarës (Kroaci)

**Prof. Dr. Aleksandar Stipčević.** Vitin e kaluar akademiku Aleksandër Stipçević botoi një libër të vëllimshëm "Tradicijaska kultura zaderskih Arbanasa" (Kultura tradicionale e Arbëneshëve të Zarës), Zagreb 2011, 425 faqe, të cilin po e përkthen shqip Instituti Albanologjik i Prishtinës. Fshatin Arbënesh (Arbanas), sot lagje periferike e Zarës (Zadar) në Kroaci, e themeluan malësorët shqiptarë prej katundeve shestanase të Kranjës (krahine malore në jugperëndim të liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit, sot Mali i Zi). Nën mbikëqyrjen e arqipeshkvit Vicko Zmajević, prej 1726-1733, u shpërngulën nga këto anë, në valë të ndryshme, rreth 450 banorë, të cilët zunë vend afër Zarës (Zadrës) dhe krijuan fshatin Arbënesh (Arbanas). Ata shumë shpejt u shtuan: më 1853 ishin 900, 1868 - 1600, 1880 - 2000, 1893 rreth 2500, 1910 - 3087; shumica e bashkëshortëve kishin mbi 4-5 fëmijë, por jo rrallë edhe 15-20 e më tepër (në kohën ndërmjet dy luftërave botërore); disa familje kishin 50 e më shumë anëtarë. Më 1790 Arbëneshi kishte 74 shtëpi, 1810 - 164, 1880 - 326 dhe më 1900 - 384 shtëpi.

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:  
**GJERGJ LEQEJZA**

**Ma.di.sh** PRODUCTION **Kimay** Produzione Giacche



# KRONIKË E VEPRIMTARIVE MË 1 GUSHT 2013, KUKEL

## Mentor QUKU

Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeore "Ndre Mjeda", Komuna e Bushatit dhe Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, organizuan më 1 gusht 2013, ora 17 e 30, në fshatin Kukel, te komunes se Bushatit, takimin Folklorik Gjithënational, në kuadrin e edicionit të Tretë të "Ditëve të Mjedës". Aktiviteti u zhvillua në përkujtim të 76 vjetorit të vdekjes së Ndre Mjedës dhe 100-vjetorit të ngritjes së Kishës së Kuklit. Merrnin pjesë banorë të fshatit Kukel, Barbullush, Bushat, Grash, si edhe të rrethinave. Gjithashtu merrnin pjesë intelektualë të shquar në lamije të ndryshme të dijes dhe jetës shoqërore, studiues, artistë, klerikë, gazetarë, përfaqësues të mediave. Kishin ardhur për të nderuar këtë veprimtari të rëndësishme personalitete, si Drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Prof. dr. Ardian Marashi, Emzot Angelo Massafra, Kryetar i Konferencës ipeshkvnore të Shqipërisë, Kryetari i Komunës së Bushatit, Konsulli i Nderit të Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza, si edhe të tjerë.

Kohë më parë se të fillonte konkurrimi, kompleksi "Ndre Mjeda" në Kukel kishte marrë pamje festive: Ishte zbuluar me flamuj nacional, me banderola të ndryshme, ku binte në sy njëra ku shkruhej "Mjeda ju pret". Kisha e Kuklit e restauruar kohët e fundit, kësaj radhe paraqitej me një risi të dukshme: Me dritaren në formë rrethi në ballë të Kishës me një vetratë me xhama me ngjyra me imazhin e Nënë Terezës. Ndërkohë që shtatorja madhështore e Ndre Mjedës mbizotëronte pamjen e përgjithshme të mjedisit ku përgatitej të fillonte aktiviteti.

Muzika shoqëruar me valle të zonës nga nxënës të shkollave të mesme të zonës që i paraprinin programit konkurrues kishin krijuar një mjedis festiv. Në një pjesë të mjedisit festiv ishte ngritur këndi me veshje karakteristike të zonës, i cili u vizitua nga pjesëmarrësit me kërshtëri. Oborri para kompleksit ishte pajisur me stola të rinj dhe zbuluar me lule shumë ngjyrëshe.

Aktiviteti filloi në ora 17.30, me fjalën e hapjes nga moderator i njohur Gjon Frroku, i cili falënderoi pjesëmarrësit, artistët, si edhe personalitetet që nderonin me këtë rast aktivitetin kushtuar Ndre Mjedës. Gjithashtu ai prezantoi anëtarët e jurisë së konkursit, prof. Dr. Afërdita Onuzi, kryetare nga Tirana, Mentor Quku anëtar nga Shkodra dhe Petrit Dushi anëtar nga Lezha. Në vazhdim të pro-

gramit të parashikuar Emzot Angelo Massafra së bashku me personalitetet e tjera vendosën tek shtatorja e Mjedës një tubë lulesh të freskëta. Konkurrimi

nga grupi "Ded Gjoluli", Tuz, Malësia. Tërhoqën vëmendjen xhamadanët e këngëtarëve, me originalitetin e tyre. Ndërkohë moderatori Gjon Frroku kishte

Me këtë rast e mori fjalën, në fillim, drejtori i QSA, Prof. Dr. Ardian Marashi, i cili foli mbi karakterin shumëpërmasor të veprës së Ndre Mjedës, me përmasa nacionale dhe madje edhe ndërnacionale. Më tej përshëndeti Emzot Angelo Massafra, që tregoi rëndësinë e ringritjes së Qendrës Muzeore "Ndre Mjeda" dhe porositi dëgjuesit për të bërë vepra të mira. Ai theksoi prirjen e Mjedës për të njohur dhe për të studiuar folklorin e popullit. Cikli i përshëndetjeve u mbyll me fjalën e Kryetarit të Komunës Bushat, Zef Hila, i cili premtoi se angazhimet e komunës së Bushatit për restaurimin dhe menaxhimin me sukses të Qendrës Muzeore "Ndre Mjeda" do të vijin duke u shtuar dita-ditës. Më tej vazhdoi program me konkurrimin e këngëtarëve, babë e bir, Llesh e Gjin Prenge me këngën "Princit të letrave shqipe" kushtuar Dom Ndre Mjedës.

Më tej program vazhdoi me këngëtarin e njohur Hana Nikprela, nga Malësia dhe SHBA, e cila këndoi jashtë konkurrimin këngën e Flamurtarit. Entuziazmi i publikut u ngrit sidomos, kur, në podiumin e shfaqjes, erdhi për të konkurruar grupi "Trepça" nga Mitrovica, i cili u paraqit me dy këngë dhe një valle. U shqua valltari Vehbi Peçi, që u paraqit me një koreografi shumë të vjetër shqiptare. Adrenalina e shfaqjes u rrit me daljen në skenë të instrumentistit frymor të njohur Gjovalin Ndreca, i cili i mahniti dëgjuesit me lojën e tij me pesë instrumente frymorë të ndryshëm. Shfaqja u mbyll me numrat e realizuar me sukses nga shoqata "Atdhetare-Dukagjini". Grupi konkurroi me këngëtarin Mark Vata me "Këngë me çifteli", Kolë Nikprela me këngën me çifteli "Le e rrit në këto male", këngëtarin Artan Nikë Prelaj me "Këngë me çifteli". Jashtë konkurrimin Agostin Pllumbi u paraqit me këngën shumë të njohur tashmë "Prizreni përshëndet Shkodrën". Në fund të takimit folklorik e meritoi grupi i Shoqatës "Ded Gjoluli", Tuz, Malësia, vendin e dytë e meritoi instrumentisti

frymor Gjovalin Ndreca, ndërsa vendin e parë e meritoi ansambli "Trepça" Mitrovicë. Në fund të fjalës kryetarja e jurisë, etnografia e njohur prof Afërdita



Monsinjon Angelo Massafro duke përshëndetur pjesëmarrësit



Pamje nga aktiviteti



Komisioni i festivalit: Prof. Dr. Afërdita Onuzi, kryetarja nga Tirana, Mentor Quku anëtar nga Shkodra dhe Petrit Dushi anëtar nga Lezha duke komunikua fituesit e festivalit

filloi me dy këngë kënduar me kushtim, shoqëruar me çifteli

konceptuar që konkurrimi të shoqërohej me përshëndetje.



Anetaret e kryesise se shoqates "Atdhetare-Dukagjini": Roza Pjetri dhe Drita Shyti me kengetaret Hana e Kole Nikprela dhe Mark Vata

Onuzi i porositi vajzat dhe nuset e pranishme në këtë takim folklorik që radhën tjetër të vishnin kostumet karakteristike të zonës, të cilat ato i ruajnë në shtëpitë e tyre.

Gjatë aktivitetit pati vizita në dy objektet kryesore të lëna trashëgim nga Mjeda, Kishën e Kuklit e cila feston vitin e 100-të të ndërtimit, si edhe shtëpinë e Mjedës e cila është edhe më e hershme, e cila u ndërtua me projektet dhe me duart e vetë Mjedës. Vizitorët u habitën me bukurinë e stilit neoklasik të ndërtesave, si edhe me mesazhet që jepte rilindësi ynë me elementet e veçanta të arkitekturës së tyre. Ata shprehën shpresën se në një rast tjetër ata do të shihnin edhe reliket e Mjedës, e në mënyrë të veçantë tryezën e famshme ku poeti krijoi kryeveprat e letërsisë shqipe.

Në përmbjllje të aktiviteteve, Kryetari i Komunës, Zef Hila, shtroi një darkë për pjesëmarrësit në një lokalet në Barbullush, ku u improvizuan këngë, valle, humor dhe përshëndetje. Darka u mbyll me urime si edhe me sugjerimin që ky takim të mbahej në mënyrë të rregullt çdo vit, duke krijuar kështu një traditë të re në këtë vend të shenjtëruar nga Ndre Mjeda.

# SHLLAKU THËNGJILLTAR

## FISI I TRIMËRISË, BESËS, TËRVESES RAKISË DHE QYMYRIT!

Shllaku një nga fiset më të mëdha, më të rëndësishëm të malësisë së Shkodrës, administrativisht herë si pjesë e Postribës, herë e Dukagjinit por etnografikisht dhe gjenealogjikisht i përket Dukagjinit. Nga llogaritja e gjenealogjive të zakonshme, Shllaku rrjedh nga Vasojeviqët ose nga Toplana se, nga Vasejoviqët rrjedhe edhe vetë Toplana. Me Shllakun shkon edhe fshati i Mazrrekut, pavarësisht se përfshinë një shumicë vllaznash të fisit të Bardhajve dhe anasve të Vukajve. Tradita popullore e (dokumentuar edhe nga At' Zef Valenti) ka ndaluar me fanatizëm lidhjet martesore mes 180 shtëpive të Shllakut me Toplanën, pasi quhen vëllezër të një barku. Me 1703 Shllaku kishte 30 shtëpi, me 153 banorë kristianë e 70 banorë musliman. Në vitin 1708 kishte 56 shtëpi, me 610 banorë, rritet më vonë në 172 shtëpi, me 130 banorë. Sipas (Gropç) me 1881 kishte 250 shtëpi, në 7 fshatra, me 1896-1897 ishte me 264 shtëpi, me 2023 banor; ndërsa në vitet dyzet të shekullit XX rritet në 300 shtëpi, në 9 fshatra BENA GUSHA, MEGULLA, VUKAJ, VASIJAJ, BERCOLLA, KRONI I MADH (Të dhënat demografike janë të autorëve të vjetër të përmbledhur nga At' Zef Valentini). Shllaku Thëngjilltar është pagëzuar pasi ka qenë atdheu i qymyrit më të mirë të Shkodrës, thëngjillorë, kishte virtytet e tij më të mira të trimërisë, të besës, të trëvesës, madje edhe për rakinë, pijen tradicionale nga më të përmendurat e malësive të Shkodrës

### MAZRREKU

Legjenda e vjetër thotë se, dikur motit, para pushtimit osman këtu jetonin dy vëllezër, Këqyra dhe Bardhi. Këqyra vël-

lai i madh, pati dy djem Idjalin dhe Ujkën, Bardhi pati vetëm një dalë të vetëm, Dervishin, i cili u konvertua në fenë myslimane. Pasardhësit e Idjalit dhe Dervishit kanë qene brez pas brezit krye-parikët e 50 shtëpive të Mazrrekut.

I gjithë fshati përbehet nga tri lagje:

**Mazrreku**, përbehet nga Dervishaj, Geraj, Brahmaj, Ujtë, Kukaj dhe Zhubaj;

**Shpori**, përbehet nga Shpori dhe Malçi;

**Mëshkalla**, përbehet nga Mëshkalla e Sipërme dhe e poshtme.

**Vllaznitë e Mazrrekut janë:**

1-Dervishaj; janë barku më i vjetër, i cili njihet si vatani

2-Krahinaj; janë të ardhur nga Gjakova e Kosova, në vitin 1962 ishin 5 shtëpi

3-Gjetë Kukajt; janë të ardhur nga Nikajt, në vitin 1962 ishin 6 shtëpi plus dhe dy shtëpi nga fshati Vuk-Jakaj i Shllakut, dy shtëpi nga Kroni i Madh i Shllakut dhe dy shtëpi nga Dushmani<sup>1</sup>

4-Shpori, i ardhur nga Mali i Zi

5-Malçi, i ardhur fshati Kroni i Madh.

6-Mëshkalla është i ardhur nga Guçia.

7-Fisi Geraj, rrjedhe nga fisi më i lashtë Idjal Uka ose Dervishaj

8-Fisi Gjon Çobaj i përberë nga tre shtëpi të vendosur në Geraj, të ardhur nga Mëlloja dhe konsiderohen një vllazni me Gerajt

### FSHATI BARCOLLË<sup>2</sup>

Në vitin 1962 kishte 32 shtëpi, me 200 frymë, gjendet në një rrafshinë malore

1. Mark Kurbini "Krahina Shllak-Temal". Studim Historik, viti 1961, fq. 37.

2. Sipas traditës gojore të rrëfyer nga Ndue Voc Ndoja, 75 vjeç, të mbledhur nga Mark Kurbini "Krahina Shllak-Temal". Studim Historik, viti 1961, fq. 37

ne Lindje të Qyteti të Shkodrës, ky fshat përbehet nga tre lagje:

1-Fushë Rada, me 10 shtëpi;

2-Vasijajt, me 10 shtëpi;

3-Barcollë, me 12 shtëpi

### VLAZNITË E FSHATIT BAROLLË

1-Fushë Radajt (Zefaj e Brahimaj, vatani. Brahimaj që nihi si vëllazina me vjetër dhe kanë banuar në lagjen Fushë Radaj);

2- Vasijajt (Ukajt dhe Likajt), që konsiderohen vatanli;

3- Bercollajt, janë të ardhur nga fisi Melaj të fshatit Vilë e Temalit me emrin e Ndue Preçit.

### FSHATI KRYEMADH OSE KRONI I MADH

Shtrihet rreth 30 kilometra larg, në Lindje të qytetit të Shkodrës, i gjithi në një sipërfaqe të repirtë malor, në parcela të vogla arash, të ndara me lugina të cekta. Ky fshat është relativisht i sheshtë. Në vitin 1962 kishte 28 shtëpi, me thuhet 220 frymë dhe përbehet nga këto lagje: Gjani, Plori, Proseku, Kryemadh ose Kroni, ose Gjoshaj dhe Pepaj.

Vëllaznitë e fshatit Kryemadh: Gjanaj, Ploraj, Prosekaj, Gjosh dhe Pepaj.

Pepaj, është vllaznia më lashtë, ndërsa si vllazni kryeparikë konsiderohet vllaznia Gjosh-Pepaj nga lagje Kryemadh. Të gjitha barqet e këtij fshati konsiderohen vendas, as njeri sa nuk mbahet mend, as nga të vjetrit as më të ritë e fshatit, ndërsa tradita gojore artikulon qartë dhe në mënyrë bindëse se fshati Kryemadh në ndryshim nga shumica e fshatrave të Shllakut, nuk ka pasur vllazni të tjera dhe as një herë vendasit nuk kanë lejuar të

vendoset ndonjë i huaj, çfarë tregon qartë homogjenitetin gjinorë të këtij fshati.

### FSHATI BENË

Banorët e sotëm nuk dinë as nuk kanë të trashiguar ndonjë legjendë rreth themelimit të fshatit të tyre, por nga ana tjetër pohojnë kolektivisht se rrjedhin prej një kohe shumë të lashtë, aq të lashtë sa nuk mbahet mend dhe se nuk ka as një plak apo të ri që mund të tregojë simbas gojdhënave më shumë se 9-10 brezni të një fisi.

Bena është një fshat i vogël, i cili shtrihet gjatë një bregorje të gjanë, rrëzë Malit Qerret, për gjatë luginës së Lumit Benë, uji i të cilit është oazi jetësorë më i begatë i këtij vendi, i cili zbret dhe buron në vendin e quajtur Ndermala. Bena gjendet mes fshatrave Kodër Nikaj, Palaj e Malit Qerret. Në Lindje kufizohet me Qerretin, në JL me fshatin Palaj, në V me masivin e Cukalit, në P me bjeshkët e Benës dhe në J me fshatrat Vukjakaj dhe Gegaj. Me 1962 përbehet nga 22 shtëpi, pothuaj me 200 frymë. Shtëpitë zgjatën një mbas një sa është vështirë të dallohen me sy. Bena përbehet nga dy lagje: lagja e Sipërme dhe e Poshtme, se cila sipas studiuesit Mark Kurbinit, në vitin 1962 kishte nga nëntëmbëdhjetë shtëpi. Bena është fshati ku ka qenë dikur kull e Bajarktarit të Shllakut:

Në ndryshim nga fshatrat e tjera pa ujë të Shllakut, arat bujqësore në Benë janë të gjitha nën ujë dhe vaditja behet me bollek, prandaj Bena është një nga fshatrat më pjellorë të kësaj krahinë, me kushte të pershtashme për kultivimin e drithërave të bukës. Ketu kultivohen të shëndetshme dhe cilësore, misri, patatja, fasulja, domatja, duhani, preshi dhe pemë si fiku dardha, mani, kumbulla, gështenja, arra, por në sasi të vogla, pasi siperfaqja e tokës është shumë kufizuar.

**Prelë Milani**

## NDAHET NGA JETA ARTAN BUSHATI

Ai që për shumë vite na fali, jo vetem ne qytetarëve të rrethit Shkodër, por mbarë Shqipërisë qindra emocione pozitive e duartrokitje të fuqishme tani nuk jeton më. Artan Bushati, apo Tani, u nda nga kjo jetë me datën 29 Gusht, pas një sëmundje të pasherueshme. Familja humbi njeriun e saj të dashur, familjarin e shkelqyer e model, njeriun e përmasës shumëdimensionale, shoqëria humbi shokun e tyre të ngushtë, njeriun e vlerave, të sinqeritit e pasionantit e pashoq, ndërsa gjithë komuniteti humbi njeriun që për shumë e shumë vite i dhuroi kënaqësinë dhe krenarinë qytetare në fushën e blertë të futbollit...dhe e gjitha kjo ndodhi atëherë kur nga Tani pritej shumë e shumë më tepër...ndodhi kur po "lulëzonte" në moshën 50-vjeçare. Tanin e njohëm cep më cep të Shqipërisë, edhe në kontakte të drejtëpërdrejta, edhe nga ekrani i televizionit edhe nga transmetimet ne Radio-Tirana tek luante në fushë duke u bërë idhull i të gjithëve dhe model për të gjithë shokët e ekipit të tij, Vllaznisë. Jeta e shkurtër e Tanit i ngjan një meteori të zjarrtë e dritëplotë që si paprimtas një ditë shkëputet e digjet në



hapsirë duke shkaktuar drithërima për të gjithë ata që e njohin dhe e shohin. I lidhur ngushtë me fushën e blertë, i domosdoshëm në mesin e shokëve të ekipit, shpresë e përhershme e tifozërisë shkodrane nuk ka se si të mos shkaktoi një brengë në ndergjegjen tonë qytetare,

të krijojë një boshllëk në mjediset ku jetoi e punoi, të na mungojë në të gjithë ritmin e jetës sonë. Tani nuk ishte thjeshtë një futbollist i shkelqyer i "Vllaznisë", por një vlerë njerëzore në vazhdimësi, një kontribues i paharruar që nga fusha e futbollit e më vonë si drejtues i ekipit

kombëtar të U-21, si trajner i skuadrës së Elbasanit dhe "Vllaznisë". Sëmundja e rëndë e bëri të dorëhiqej nga shkodranët në ditët e para të muajit korrik, me shpresën për ta mposhtur sëmundjen...por ja që Ai, Tani, që kishte fituar qindra sfida e na kishte dhuruar qindra emocione e kënaqësi, ne sportdashësve shkodranë, këtë radhë na "dhuroi" më të hidhurën, ndarjen nga Tani nga jeta.

Përciellja që iu bë nga familjarët, të afërmit, miqtë, shokët dhe i gjithë komuniteti shkodranë, e më gjerë, ishte një deshmi e gjallë e vlerave të tij në jetë. Humbja e tij ishte shokuese. Vërtetë që Tani nuk jeton më midis nesh, por ajo që Ai bëri për ne gjatë jetës së tij e bën të pavdekshëm në ndergjegjen e kujtesën tonë. Në kuadrin e vlerave të gjithanshme që ka qyteti i Shkodrës, kontributi i Tanit do të mbetet gjithnjë një vlerë e veçantë, një krenari për familjen e mbarë shoqërinë shkodrane.

**LAZER KODRA**

# NË BREG TË BUBËS – THETH

## (NGA BLLOKU I SHËNIMEVE)

1. Sa më shumë të rritesh në moshë gjithnjë e më shumë të shtohet dëshira për vendin ku je lindur, rritur, ku ke pasur gëzime por edhe mërzitje, ku është toka që na lanë të parët e ku prehen eshtrat e tyre.

“S’ka madh më të madh se malli për vendlindjen” thuhet te filmi “Udha e shkronjave”. Në këto momente më vjen në mendje një bisedë e bërë me Ndue Markun nga Ndërlysa mbi 20 vjet më parë. Rastësisht, ndërsa po kthehesha nga Rragami për në Theth, pasi kisha qëndruar disa ditë te kushëriri im Fran Shyti, gjatë rrugës takohemi në Brinjën e Shkallës. Ai, ishte një burrë i qetë, i avashtë në të folur, fliste pak, por me mend, ishte trupgjatë, tipik malësorë. Ecte me hapin e tij jo të shpejtë, por të plotë dhe me ritmin e njëtrajtshëm. Po pushonim në Buni të Shtjerrave dhe po shikonim me vëmendje Rragamin e Shalës, pasi e kishim përballë dhe shikohej, siç i thonë, “si në pëllëmbë të dorës”. Ai, me zërin e tij që dukej sikur dilte nga thellësia e maleve që kishim rrotull tha: “E more kumbarë, këto bjeshkë nuk kanë shoqe, vetë zoti i ka bekuar. Eh, në këtë moment mbushet me frymë thellë dhe pastaj vazhdon: ... sa më shumë rritet moshë e njeriut aq më shumë shtohet malli për vendin ku ka le dhe je rritë”.

2.

I gjithë Thethi është shumë i bukur, është një perlë e vërtetë, është i papërsëritshëm. Një nga vendet më të bukura të këtij fshati, në mos më i bukur, është Bregu i Bubës. Ai është një territor rreth 1300 m mbi nivelin e detit, në shpatin lindor të fshatit, në rrugën që të ngjitë

në Qafë të Valbonës. Tradicionalisht kjo qafë quhej “Qafa e Balbonës”, por nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar e në



Grupi i piknikut në breg të Bubës



Grupi i piknikut duke ecur në hapësirën e bregut të Bubës

vazhdim erdhi duke u përforcuar emërtimi “Qafa e Valbonës”.

Bregu i Bubës ka një sipërfaqe rreth 70 Ha. Livadhe të rrethuara nga pyll ahu, i cili gjithnjë e më shumë po mbulon sipërfaqen e këtyre livadheve shumë të mira. Nga këto livadhe shikohet gjithë fshati Theth, por edhe një pjesë e madhe e Luginës së Shalës. Këto livadhe kanë katër burime ujë të freskët si dhe përshkohen nga Prroj i Lugut të Oksetit që zbret nga shpati i malit.

3.

Si çdo vend, edhe këtu ka shumë toponime, por interesant është se të gjithë këto livadhe emërtohen me një emër të përbashkët “Bregu i Bubës”, por në asnjë pjesë të tyre nuk ka një vend që të quhet kështu, por me emra të tjerë.

Disa nga toponime janë: Kryja, Thepi i Krysë, Lugu i Krysë, Shpati i Krysë, Zhari i Krysë, Shpati i Krysë, Rrethi i Qukeve, Mrizi i Lukthit, Logu i Mrizit të Lukthit, Lugu i Lukthit, Shpati i livadhit të Gjekës, Kodra e Livadhit të Gjekës, Kroni i Ligatës, Ligata, Roga e Fierit, Nënbregru i Bubës, Roga e Nikës, Quku i Konakut, Orrnica, Kroni i Orrnicës, Quku i Gjothit, Dardha e Ndokës, Quku i Lukthit, Livadhi i Rrokut, Livadhi i Vuksanajve, Zhari i Palnave, Palnat e Pllumbit, Livadhi i Gjokotës, Lugu i Oksetit i Gjergj Prelës, Kroni i Myshkës, Lugu i Oksetit i Tul Vatës, Kroni i Hasës, Livadhi i Gjelosh Ujkës, Guri i Mullinit, Roga e Sokolit. Sigurisht që mund të kem harruar edhe ndonjë tjetër.

4.

Përsëri dhe përsëri në Breg të Bubës. Sa herë që të vish këtu edhe më shumë të shtohet dëshira për të ardhur përsëri.

Njëra nga këto ditë përvëluese të gushtit për shumë banorë të lagjes Gjellaj të moshave të ndryshme nuk është e zakonshme. Po ngjitemi të përpjetës së fortë, por të bukur drejt këtyre livadheve përmes freskisë së ajrit të bjeshkës nën hijen e aheve.

Herë pas here përshëndetemi me turistë të nacionaliteteve të ndryshme të botës. Dikush na përshëndet “Hello”,

dikush “Çiao”, dikush me dorë dhe dikush me kokë. Ka edhe nga ata që na përshëndesin me shprehjen e bukur shqipe “tungjatjeta”, por me theksin e të huajit. Gjithsesi mirë, bukur.

Në këto livadhe “zhurmat” e sotme nuk janë të zakonshme. Janë zëra nga të gjithë brezat. Këtu, sot ka pothuaj pjesëtarë nga të gjitha familjet që banonin në Gjellaj nga fundi i viteve ’80. Kjo tregon se përvoja dhe dashuri për këtë vend po kalon nga brezi në brez.

Ka ardhur Preka me djalin e tij Agninin dhe nipin, Saimoni, që është vetëm 5 vjeç dhe pjesëtarë më i ri sot; Gjoka me djalin, Alberti nga Shkodra; Martini me djemtë, Lekën dhe Franin nga Shtoji i Vjetër; Marashi me djemtë e tij, Kristiani dhe Alfredin; Zef nga Italia me djalin e tij Toma; Lulashi nga Shkodra dhe Gjovalini nga Italia; Jetmiri nga Shkodra; Pali nga Gruda e Re e Rroku nga Italia; ka ardhur edhe Besnik Përpali nga Tirana; Ndou me djalin, Silvestrin nga Shkodra, e të tjerë, të gjithë kushurinjtë me njëri tjetrin. Natyrisht që nuk kanë ardhur të gjithë pasi punët dhe shpërndarja e largët nuk i kanë mundësuar, por gjithsesi me mendje e zemër janë këtu. Ne i kujtojmë dhe i respektojmë të gjithë.

Është shumë bukur. Krijohet një mjedis shumë i këndshëm. Dikush merret me fërlikun rrëzë një kodre, një grup luan volejball e një tjetër futboll në tapetin e gjelbër të livadhit në Lug të Krysë, ndonjë këndon e një grup tregojnë barcoleta, zërat dhe të qeshurat e tyre përhapën këndshëm.

Mos u shqetësoni, thotë Martini, se topi nuk ikën larg sepse nuk e lejon bari. Vërtetë bari është shumë i rritur që ka filluar edhe të thahet i pa kullotur nga bagëti, dhe i pa kositur nga dora e njeriut.

Pas një lodhje jo të vogël nga ecja dhe loja mblidhemi në Lug të Oksetit, nën hijen e aheve. Leka, Zefi, Ndoja, Marashi e te tjere kanë marrë të gjitha masat që të mos mungojnë asgjë në këtë drekë. Gjithçka është e plotë, e mbi të gjitha gazi dhe hareja nuk kanë të sosur.

LUIGJ SHYTI

## KONTRIBUTI YNE SI MESUES NE DUKAGJIN

Ne zonat e ndryshme te Dukagjinit punuan e medituan per me te miren ,per progress dijesh ,shpesh flitnin edhe per tolerance e cila duhej aq shume.Nxensit gjithmone na mirkuptonin,ngrenin diskutime edhe ne shtepite e tyre ,qeshnin kur na tregonin per keto biseda sidomos reagimin e prinderve .Keta mesues ishin me dhjetra nga Shkodra ,Malsia e Madhe e Dukagjini.Per hire te vertetes mesuesit nga Dukagjini ,jo per kompliment, por qene ne balle te punes dhe ne na lehtesonin shume punen .Humori i tyre qe i mprehte si hijet e Parunit . Mendoj te permend disa emra te cilet ishin ne majat e punes ,shumica e tyre edhe u dekuruan .E di se do le jashte shume prej tyre per fajin e memories time,por gjithesesi ne kontribuam per ndritjen e mendjes ose shendoshjen e saj nga disa koncepte qe me mund e djerse i flaken larg .Ne beme

me te miren per higjenen,lajmin neper-mjet gazetave apo radios,aktivitetet artistike e sportive,ekskursionet me tematik mesimore etj nuk jan pak per ate kohe mendoj.Malsoret me mendjen e kthjellat si nxensit ashtu edhe prinderit na mesuan edhe ne jo pak.Atje ne dukagjin u motiveam nga bukuria natyrore, ujerat e kristalta,bukuria e relievit,ndaj edhe ne punuam mire.Krijuam shoqeri qe e ruajm edhe sot.Shpesh shkruaja dicka per nje gazet lokale per ngjarjet, realizimin e planeve ne kooperativë per tu bere pak moral njezve te punes .Aty degjoje sin je musike e akorduar mire, gurgullimat e ujit,tring-tringet e bagtive,sa kenaqesi. Them eshte mire te bej nje apel “O njez kujtoni e respektoni mesuesit qe sa ditën e munden kontribuen per ju”. Sado pak kujtoni emrat, pershendetni ne rruge ku ti takoni ata qe jane gjalle.

Jam ende ne pune por edhe une mendoj per njezrit,bjeshket,ditet e bukura e te veshtira atje ku punova.Me bindje u them pasi ende jam aktiv ne jete se per nje perjudh jot e gjate do shkoja prap per te ndihmuar sado pak ne profesionin tim.Do bej perpjekje te shtrill trurin tim pasi kane kaluar shume vite per tu kujtuar komuniteteve mesuesit qe nuk jetojne me si:Kole Prela, Frano Gjellaj, Nikolin Leka, Ded Mrapshtia, Dode Kaçaj, Prele Bregu, Marash Miruku, Pjeter Selimi etj. Shume te tjere kane kryer detyren e vet dhe kane fituar respektin e komunitetit si :Mahir Hoti,Fran Vatnikaj,Shpetim Lame,Pal Rupaj,Fatos Gjyrezi,Prele Shytani e te tjere qe do me falin per ndonje gabim njezvezor.Shume te tjere punuan ne Shale e ne Shosh si :Zef e Lazer Fusha,Kole Çardaku,Shefki Molla,Kadri Fikaj etj.Pulti zone disi me e bute e me afer Shkoders kontribuan Ismail Hoxha ,Mehdi Shkreli,Viktor e Enriketa Gjoka,Age Çokaj,Rexhep Sheqeri,Ndoc Odri etj.Po si u paguam ne mesuesit e perkushtuar pas profesionit? Mendjet e ndritura te malsoreve ku ne kontribuam

na e shperblyen me se miri pasi me dhjetra kryen universitet per mjeksi si Ndoke Marku ,Ndoc Shtepia ,Prel Martini ,me dhjetra mesues e agronom, aviator, economist e te çdo lloj tjetër profesioni. Nxensit i “dekoruan” mesuesit e tyre bashke me prinderit me fjale, me respect e perparim . Sa bukur eshte kur nxenesi ia kalon mesuesit!- kenaqesi e vertete! At-eghere kam te drejte te pyes: Sa shkolla moren emrin e mesuesit? Shkolla eshte tempulli i dijes dhe jo I trimerive. Trimat jane me lapidare, me emra rrugeshe e sheshesh. Sa mesues u bene “Qytetare nderi”?- kaq pak more zoteri pushtetar kontribuan mesuesit!? Nese kam gabuar , kerkoj ndjese, por iu them me bindje se bera shume pak per keta njezve te ditur, fundja obligimi im eshte me shume respect e dashuri, me qellim qe t’ua kojttoi atyre qe i harruan. Pikat e shiut gdhendin gurin/ Mesuesi gdhend trurin/ Mesuesi i afte e punetor/ Eshte emblem e fshatit, komunese me shume. Ju lutem nxenes mos e harroni kurre mesuesin tuaj. Respekt per punen, mundin e sakrificat qe bene.

ANGJELIN LEKAJ

## “Ç`ma more kalanë nga brënda o Jovan Bregu!”

ESE... nga Lazer Kodra



Të gjithë e kemi parë të ndjerin Roland Trebickanëroline Jovan Bregut tek komedia e famshme “Pallati 176”. Interpretimi i tij i shkelqyer dhe shprehja e drejtor Perikliut : “Ç`ma more kalanë nga brënda o Jovan Bregu!” më është ngulitur në mendje dhe herë pas here , krejt natyrshëm ,më krijon korospondenca me ngjarje të kohës apo të ditës apo edhe të çastit. Jovani në thelb nuk ishte i keq. Fundja ..vdiste për një copë magazinë dhe ... kaq! Marrja e “kalasë”

nga brënda tashmë është një model i aplikueshëm lehtësisht nga njerëz që asgjë më teper nuk u mungon se sa cipa njerëzore. E dimë shumë mirë , edhe nga historia edhe nga letërsia se si u muar Kalaja e Trojës nëpërmes Kalit të drunjtë, i cili u dha si dhuratë dhe pastaj nga barku i tij dolën ato gjallesat e famshme që pushtuan e dogjën me zjarr e hekur Kalanë e famshme, për të cilën kemi edhe dy kryevepra të letërsisë botërore: “Iliaden” e “Odisenë”. Por nuk u ndal me kaq, pasi “Kali i drurit” mbeti jo vetëm simbol i dredhisë e pabesisë së madhe, por ai u rrit, u specifikua dhe u bë pronë e patundshme e disa gjallesave, që nën ndikimin e dhunës së përhershme që ushtrohet mbi materien, moren formën njerëzore. Madje në Evropë pati edhe një Lëvizje artistike të llojit “Kalë druri” e të emertuar: Dadaizëm (kalë druri) që udhëhiqej nga Tristian Tzara dhe Hugo Ball. Po tani ka kalë druri apo jo? Po, tani ka shumë kuaj druri. Na sillen çdo ditë nëpër këmbët tona. I takojmë ndër sheshe. I takojmë në mbledhje, në lokale, në trotuare. Kanë forma të ndryshme. Janë thatanikë-shalëgjatë, trashalugë-syhumbur, me forma të ndryshme, por që e mbajnë mjaft mirë kalin e drunjtë. I vetmi ndryshim ,pas tre mijë vjetësh është se në atë kohë hynë gjallesat-njerëz në barkun e kalit, ndërsa tani ka hyrë kali i drunjtë brenda gjallesës -njeri. Kanë dhunti të jashtëzakonshme. Njëherë të fyejnë, pastaj të joshen, pastaj të ledhatojnë, pastaj të puthin ,pastaj shiten në emrin tënd, pastaj nuk e kanë për gjë që të të fyejnë përsëri! Janë specie që i përkasin metamorfozës së shpejtë në kuadrin e interesit vetanak. Sa i urrej këto gjallesa!!! Herë pas here i flas ndërgjrgjes sime ashtu në heshtje: O Zot na ruaj nga “kuajt e drurit” edhe ne , por edhe shoqaten tonë!



## Një jete me Nene Terezën

Libri “Jete me Nene Terezën” përmban dhe përshkruan kujtime të një njeriu të zgjedhur nga Zoti, të një njeriu që eci krahu për krahu me Nene Terezën dhe punoi me të për çështjen e të varfërve, për më se 30 vjet, U kërkoj lexuesve që të mos mërzojnë nga referimet personale, t’i shikojnë ato me durim dhe të përvetësojnë çdo gjë, që mund të jete e mire, e frytshme dhe me përfitim për ta.

Përpara se, të fillojmë librin, do të dëshiroja t’ju tërhiqja vëmendjen në Shqipërinë e së nesërmes, që praktikisht janë Shqipëria e së kaluarës, Shqipëria e tashme dhe Shqipëria e së ardhmes.

Duke folur për Shqipërinë e së djeshmes, dua të përmend dy Shqiptare që, nga 1946 e mbra-pa, u bene figura të Shquara. Njeri ishte Enver Hoxha, diktatori që u mundua të krijojë një Shqipëri pa Zot. Ai, për te nuk ishte i rëndësishëm dhe Zoti nuk i duhej as njerëzve të tij. Ai dhe qeveria e tij punuan pa u lodhur për ta zhdukur besimin në Zotin e gjithëpushtetshëm, të gjithëdijshëm dhe të gjithëpranishëm nga zemrat e njerëzve, Zoti ishte i tepërt për te. Priftërinjtë u arrestuan, shumica u pushkatuan, të tjerët u detyruan të punonin, Kishat u konfiskuan dhe u kthyen

në pallate sporti, teatro e muze të ndryshme. Ai i beri njerëzit e tij të besonin që njerëzit e Shqipërisë pa Zot, ishin njerëzit më të lumtur në bote. Që në Mars të vitit 1967, me ligj, Shqipëria u shpall shtet ateist, që do të thotë se çdo njeri, që kishte te bënte me Zotin ose besimin, do



të dënohej, e madje edhe me vdekje. Në shkolla dhe universitet s’mund të përmendej emri i Zotit. Katedralja e Madhe e Shkodrës, në veri të Shqipërisë u përdor si pallat sporti e gjera te tilla. U ndryshuan edhe pamjet e jashtme për ketë qellim. Me vdekjen e diktatorit në 1985, filloi të vdesë edhe Shqipëria e tij pa Zot. Me 15 Dhjetor 1989, disa nga priftërinjtë shqiptare,

që kishin mbijetuar, celebruan edhe një here Meshën e Shenjte nga Meshar Romak prej Koncilit të Trentos. Ata s’kishin dëgjuar kurrë për Koncilin e dyte të Vatikanit, ose për ndonjë ndryshim liturgjik. U deshën disa vjet me shume që ata 23 priftërinjtë shqiptare, që kishin mbijetuar,

shumica e të cilëve ishin persekutuar te marrin vesh ndryshimet e shumta dhe rinovimet e bëra në Kishë. Por, për ta nuk ishin te rëndësishme ndryshimet, e rëndësishme ishte të mund të praktikonin përsëri besimin tyre!

Me 25 Prill 1993, i ftuar nga Shkëlqesia e tij, Nunci Apostolik Ivan Dias, Ati i Shenjte, Gjon Pali i Dyte, vizitoi Shqipërinë.

Në atë dite të bukur, Katedralen e rinovuar të Shkodrës, Papa konsakroi katër ipeshkëv të Shqipërisë: Arqipeshkvi Frano Ilia i Shkodrës, Arqipeshkvi Rrok Mirdita i Tiranës e Durrësit, Ipeshkvi Zef Simoni dhe Ipeshkvi Hasda i Pultit në male.

Arqipeshkvi Frano Ilia ishte dënuar me vdekje me 25 Prill 1968, por për disa arsye dënimi me vdekje ishte ndryshuar në burgim të përjetshëm. Më vonë, me 25 Prill 1993; ekzakt 25 vjet me vonë, në jubileun e dënimit të tij me vdekje, u konsakrua ipeshkëv në Katedralen e Zotit, janë me të vërtetë misterioze. “Kush e ka njohur mendjen e Zotit apo kush ka qene Këshilluesi i tij?” (cf. Rom11:33-36).

Në kemi Shqipërinë e të së Kaluarës, me kujtimet e saj të shumta e të dhimbshme në një rëndësi dore dhe me dashurinë e paprekshme e me hirin e mahnitshëm, në dorën tjetër. Pavarësisht nga çfarë ka qene e kaluara, le ta kujtojmë me mirënjohje, mbase edhe persekutimet e para në Roma nuk kane qene aq të ashpra, aq brutale e totale, por Zoti është Zoti,

Është pikërisht në të njëjtën periudhe që Jezusi zgjodhi një grua me gjak Shqiptar, që po punonte me gëzim e për Zotin, Me gjithë mendjen, zemrën e shpirtin e saj, në qytetin që u nis me anije nga Dublini, Irlandë, dhe arriti në Kalkute me 6 Janar

1929.

Me 25 Prill 1993, i dashuri dhe i pa harruari ynë, Papa Gjon PALI I DYTE NGA BALLKONI I DHOMES SË ARKIPESHKVIT NË SHKODËR, SHQIPERIA THA PËR KETË GRUA: “... Nga Kryqi, Jezusi lutej për atë që e kryqëzuan, shembull i një dashurie pa kushte, i një jete që shkon më larg se fryerjet që i janë bere, dhe që është gati të ofroje falje ...”. Shqipëria e sotme mund të jete krenare nëse jeton idealet e bijës së saj të Bekuar Tereza Bojaxhiu, Nena dhe motra e së cilës pushon në varrezat e Tiranës. e ardhmja e Shqipërisë ashte e sigurt deri kur njerëzit e sotme të ndjekin shembullin frymëzues e ndër-tuese të kësaj bije të dashur, të Bekuarës Tereza Bojaxhiu. Madje, ajo ka marre edhe vlerësimin ma të madh, çmimin “Nobël” për paqe, me 10 Dhjetor 1979. Le të behet Nacionaliteti Shqiptar një instrument paqeje e gëzimi. Le të ketë paqe e le të filloje në Shqipëri. Për ketë, unë lutem dhe kërkoj lutjet e të gjithëve!

Këto rreshta u morën nga libri “Jete me Nene Terezën” - Atë Sebastian Vazhakala M. C, sot paderi gjeneral të misionit “Madre Teresa”, i cili punoi dhe jetoj me te për 30 vjet me radhe.

Përgatit Gjin Musa, nga Roma, në kuadrin e 103 vjetorit të lindjes së Nene Terezës

# Aroma e Verës në Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini"

Në kuadrin e 10 vjetorit të themelimit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe të punës që po bëjmë me afrimin e të rinjve dhe të rejave në gjirin e shoqatës, gjatë muajve Korrik-Gusht 2013, kemi organizuar disa veprimtari, ne te cilat vendin kryesor e kanë zënë të rinjtë dhe të rejtat, të cilët janë ndierë mirë dhe pasi janë njohur edhe më nga afër me shoqatën, ata shprehen të lumtur dhe krenar që tashmë janë pjesë e saj. Duke marrë mendimet e tyre ne e ndjejmë vetët edhe më të mirë dhe më të guximshëm për të ardhmen. Te punosh me të rinjtë dhe të rejtat do të thotë të punosh për të ardhmen që ajo të jetë më e mirë.

**Veprimtaria e Parë**, u zhvillua në formën e një pikniku, me datën 28 Korrik 2013, ditën e Diel në fshatin Dogë, ne rajoni Okol. Veprimtaria u zhvillua në kujdesin e Nënkrjetarit të shoqatës, Gjergj Leqeja, dhe anëtarëve të kryesisë, Aleks Dushi, Dukate Bregu dhe Roza Pjetri. Gjatë gjithë rrugës për në Okol ne takuam turist nga shumë vende të botës, të cilët ktheheshin nga Thethi. Ajri i pastër i bjeshkës dhe natyra e bukur ishin frymëmarrja jonë e parë (përfundim ndonjë teshtije që të dhuronte alergjia ndaj luleve të shumëllojshme të livadheve). Çdo gjë ishte e organizuar, që ta kalonim këtë ditë në mënyrën tradicionale, ku edhe menyuja ishte tradicionale e përgatitur bashkërisht. Nuk do zgjatim shumë sepse janë përshtypjet e të rinjve që do na njohin edhe më shumë me ecurinë e kësaj dite.

**Marijona Pjetri**: - Jam shumë e mahnitur nga ky piknik. Më përpara, kam shkuar në piknik me familjen, por edhe këtu e ndjeva vetën si në familje. Edhe pse amë më e vogla e grupit, amë ndier mirë dhe e kënaqur që mu dha rasti të përjetoja një ditë në gjirin e kësaj shoqatës, së cilës i uroj suksese dhe jetë të gjatë sa bjeshkët që na rrethojnë.

**Jona Leqeja**: - Me jetën e shoqatës jam njohur nëpërmjet babilimit, Gjergjit, i cili me flet vazhdimisht për jetën e saj. Prandaj edhe kur më tha se, do të organizonit një ditë të tillë, menjëherë i kërkova që të jem sot këtu, me ju për mua është një ditë e veçantë pasi ka shumë të veçanta, të cilat e ndërtuan. Dua ti falënderoj nga zemra të gjithë organizatorët. Sa i përket jetës së Shoqatës, besoj që do ndjek hapat e babilimit dhe të jap një kontribut modest, edhe unë te jem një pjesë e ecurisë së saj, e cila të jetë në dobi të promovimit vlerave të Dukagjinit dhe dukagjinaseve.

**Petriti Aramalli**: - Edhe për mua është hera e parë që marrë pjesë në një veprimtari të shoqatës dhe fati paska qenë me ne, që po e fillojmë jetën në shoqatë, me një ditë dhe në një vend kaq të bukur. Jam ndier shumë mirë dhe shpresoj që këto veprimtari të jenë më të shpeshta. Më ka pëlqyer mënyra e organizimit, ku çdo njëri nga ne kontribuam në të gjithë aspektet e realizimit të saj dhe kjo në dha mundësi të jemi më të afërt dhe shpresoj që edhe jeta e shoqatës kështu duhet të



Në foto Aleks Dushi, Dukate Bregu, Jona dhe Gjergj Leqeja, Lulash dhe Mri Brigja, Marijona Pjetri, Kozeta Bruçi, Diana Gjeka Keqaj, Ela Kodra dhe Petrit Aramalli



Çastet e drekës në natyrë

vazhdoi.

**Diana Keqja**: - Ju falënderoj që na dhatë mundësinë të përjetojmë një ditë shumë të mirë, në një vend dhe atmosferë të mrekullueshme. Përgëzoj shoqatën për veprimtaritë e saj, të cilat janë të organizuara shumë mirë. Më pëlqen fakti që ju po i jepni rëndësi pranisë së të rinjve dhe është e domosdoshme, sepse prania e të rinjve në Shoqatë i jep mundësinë asaj për një të ardhme të mirë.

**Mri Brigja**: - Jam shumë e kënaqur që sot përjetoja një ditë krejt ndryshe nga e përditshmja. Kur më tha bashkëshorti im, Lulashi të vija në këtë piknik, isha në mëdyshje. Tani e falënderoj që këmbënguli

të më merrte me vete dhe ju falënderoj edhe ju si shoqatë që krijoni veprimtari, ne te cilat ne, e ndjejmë vetën mirë si një familje e madhe. Që në momentet e para të kësaj dite e kam ndier vetë shumë mire, sepse edhe pse me shumë prej pjesëmarrësve unë takohesha për herë të parë, ata e krijuan atmosferën të atillë që të gjithë e ndjenim vetën sikurse njiheshim prej kohësh. Më beri përshtypje tek po gatuaja, aktivizimi i të gjithëve në punët të ndryshme edhe pse moshat dhe profesionet ishin të ndryshme. Ju falënderoj për zemërsisht dhe ju uroj që shoqata jonë të ketë jetë të gjatë.

**Ela Kodra**: - Kjo ditë për mua është e

mrekullueshme për faktin, sepse ajo u ndërtua shumë bukur dhe ju dha një karakter familjar. Njihesha vetëm me disa prej pjesëmarrësve, por nuk u deshe që të kalonim shumë minuta, që hezitimi se si do e kaloja këtë ditë u zhduk. Më bëri përshtypje bashkëpunimi i anëtarëve të shoqatës me njëri-tjetrin dhe ky është një shembull shumë i mirë për ne që jemi të rinjtë. Uroj që ky bashkëpunim të vazhdojë, sepse do të jetë një garanci për të ardhme. Duke qenë se, më besuat që të ju gatuaja së bashku me Mrinë, jam e lumtur që mu dha rasti të bëja diçka, por e kisha shumë të lehtë, sepse ju na ndihmuat. Ishte kënaqësi për mua kjo ditë.

tashme një qetësi shpirtërore.

Dikur piknikët kane qene një tradite për kolektivët e punës, apo dhe grupe shoqërore. Por faktorët e ndryshimeve që shoqëruan edhe ndërrimin e sistemeve duket sikur prishen ca tradita te mira dikur.

Kësaj radhe iu përgjigjem ftesës që na u bë nga një pjesë e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", me qëndër në Shkodër, për të udhëtuar drejt Okolit të Boges, vendi i zgjedhur prej tyre për të bërë një piknik. Organizimi i një pikniku me shume sesa një shoqëri të mirë kërkon njerëz që e duan natyrën dhe e shijojnë atë. Vlerat e një pikniku nisin që nga njohja me vende të reja, lëvizja në terren, që sjell një gjendje të mirë shpirtërore dhe fizike, provimi i resurseve që të ofron vendi i zgjedhur për piknik si dhe mundësia për të qene mire shpirtërisht. Duke qene në një distance larg qytetit duket sikur problemet e jetës atje bëhen me të vogla e kështu, pse jo mund të mendohet edhe zgjidhja e tyre.

Ky shembull i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", flete vete, flete shume për punën e saj. Jo vetëm për këtë veprimtari, por edhe për gjithë aktivitetin e saj në shërbim të komunitetit, të anëtarëve të saj, të rinjve, në shërbim të kohës.

**Veprimtaria e Dytë**, ishte me datën 1 gusht 2013, dite enjte, ora 17.00, në famullin e Kuklit, në kuadrin e edicionit të tretë të veprimtarive «Ditët e Mjedës», në të cilën u zhvillua veprimtaria «Takimi folklorik gjithë-nacional», në përkujtim të 76-vjetorit të vdekjes së Dom Ndre Mjedës dhe 100-vjetorit të ngritjes së Kishës së Kuklit.

Kjo veprimtari u realizua në kujdesin e famullitarit të palodhur prof. Dr. dom Nike Ukgjinit, Kryetarit të komunës së Bushatit, Zef Hila, Konsullit të nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza, Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës Muzeore «Don Ndre Mjeda». Veprimtaria në ndero dhe prania e kryetarit të Konferencës Ispeshkvnore të Shqipërisë Shkëlqesia e Tij Monsinor Angelo Massafra. Për këtë veprimtari, është një kronikë e veçante nga Mentor Quku.

**Veprimtaria e Tretë**, ishte vizita që disa përfaqësues të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" bënë në krahinën e Hotit. Të ftuar nga Shoqata Kulturore Artistike «Ded Gjon Luli», me datën 13 Gusht 2013, dite e marte, në orët e pasdites udhëtuan për në Hotin legjendar. Në doganën e Hanit të Hotit kishin dal për të na pritur vëllezërit tonë hotjan, disa prej tyre kishin ar-



Pamje nga veprimtaria



Pamje nga veprimtarite në rajonin e Traboinit, përfaqësuesit e shqazës "Atdhetare-Dukagjini"



Foto e luftëtarëve dukagjinas në Bratilë

dhur për pushime nga Amerika e largët. Pas një prezantimi të shkurtër, udhëtimi vijoi për tek Shtëpia muze e Ded Gjon Lulit. Ishte emocionuese për të gjithë në të gjendesh në krahinat shqiptare, të cilat dhe sot përcjellin jehonën e shekujve. Valëvitja e Flamurit Nacional në oborrin e shtëpisë muze të përkëdhelë dhe shpaloste para nesh nëpërmjet vëllezërve hotjan historinë e këtyre krahinave shqiptare. Ishte kënaqësi të dëgjoje tek flisnin me radhë të gjithë në lidhje me historinë dhe çdo element të kësaj shtëpie muze. Më bëri përshtypje dëshira e madhe për të folur për historinë dhe njohja edhe në detaje më intime të kësaj historie të lavdishme. Për ne dukagjinastë emocionuese ishte edhe një foto e luftëtarëve Dukagjinas pjesëmarrës në ngritjen e Flamurit në Bratilë.

Pastaj vizita jonë vazhdoi tek Kisha e Traboinit dhe tek Kroji i Traboinit, në të cilin vëllezërit tanë sipas traditës, kishin shtruar një darkë vëllezërore. Aty ne, u njohëm edhe me hotjanë dhe grudjan të tjerë, të cilët kishin ardhur nga emigrimi për pushimet verore. Darka pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Shoqatës Kulturore Artistike «Dede Gjon Luli», Gjon Dushaj, u shoqërua me këngë dhe valle të traditës, të cilat u kënduan nga pjesëtarët e kësaj shoqate dhe këngëtarët e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjin", Mark Vata, Agustin Pllumbi, Floriana Shtylla dhe i ftuari special Pjerin Gjon-dreka.

I falënderojmë përzemërisht vëllezërit Hotjan, Shoqatën Kulturore Artistike "Dedë Gjon Luli", që e organizuan këtë veprimtari, e cila shërbeu për lidhjen edhe më të fortë me vëllezërit tanë që padrejtësisht jetojnë jashtë kufijve shtetërore. Por kjo nuk na pengon për qenë gjithmonë bashkë ashtu si shekujt na e lanë trashëgimi. Mbetet kujtim shumë i mirë për ne që ishim të pranishëm në PRAGUN ku u holën themelet e PAVARSISË së Nacionalitetit Shqiptar.

Faleminderit vëllezër Hotjan! Falënderojmë dhe anëtarin e kryesisë së shoqatës, Mhilli Prroni, i cili mundësoi pjesëmarrjen në këtë veprimtari. Falënderojmë për organizimin dhe pjesëmarrjen Ndreken dhe anëtarët e shoqatës Ilirin, Silven, Dukatën, Rozën, Agustinin, Markun, Pjerinin (të ftuarin tonë), Florianën dhe Denisa (vajza e Gjin Musës bashkëpunëtorit tonë në Romë), të cilës gjatë këtij aktiviteti ju dha mundësi të njihen edhe më nga afër me shoqatën dhe jetën e saj.

Roza Pjetri

# SHOSHI NË POEZI

Urime Shoshit, për ruajtjen e vlerave të pastra zakonore ,tradicionale të Dukagjinit. Shoshi, si çdo zone tjetër e Dukagjinit ka historinë e tij të lavdishme në të gjitha fushate jetës njërzore. Pozita gjeografike e ashpër e këtij vendi kaliti natyrshem tek banoret e Shoshit dhe krejt Dikagjinit, trimërinë ,burrërinë,besnikërinë, mikpritjen dhe mbi të gjitha mençurinë. Unë i njoha mirë shoshjanët, prandaj niej obligim që cilësitë e tyre të shkelqyera (bashkë me ata që shkrujnë) t'i bëjmë të njohura për shoqërinë dhe brezat e rinjë, sepse historia ka lënë gjurmët e saja në çdo kohë dhe ato s'kanë sit ë mbesin mistike.

Faktikisht njerzit e kanë shkruar Shoshin, kush në një menyre kush në një tjetër, njëri më shkurtë e tjetri më



gjatë, në formë proze ose poezie, por përfundimi ka nxjerrë në dritë po të njëjtën bërthamë, atë të realitetit të vlerave të një populli9 kaq të mrekulueshëm.

Shoshi ka fatin e veçantë se nuk vuan për t'i nxjerrë në dritë identitetet e veta të shkelqyera, qoftë të çdo kohe apo situate, sepse ai

kalindë vetë shkrimtarët, poetët e nderuar e të promovuar, të cilët sot i njeh mbarë e gjithë Shqipëria.

Shkrimtarët e nderuar shoshjanë kanë shkruar për vendlindjen e tyre natyrshëm, me profesionalizëm dhe intiligjencë, me vlerat mahnitëse të natyrës dhe fisnikërinë e shoshjanëve. Fakti që më ka shtyrë mua t shkruaj për Shoshin, vjen nga pasioni dhe frymëzimi për të shprehur mirënjohjen për çdo gjë të bukur që unë kam gjetur atje në vitet e para

të kolektivizimit, një jetë plot dëshira, gëzim, harmoni e bujari, me mbështetjen e fuqishme që ata u kanë dhënë jabonxhinjëve të asaj kohe, prandaj ato kujtime unë i raj si pjesën më të bukur të jetës time, në mes të shoshjanëve, me zakonet, traditat dhe pasuritë morale-shpirtërore dhe virtytet e tyre të larta, duke u krijuar mundësinë sejcilit të hynin në zemrat e tyre të pastra e të sinqerta.

Vertetë jeta evolon dhe njerzit largohen në hapsirat mërgimtare dhe në kushtete distancueme ato humbin kontaktet qoftë edhe familjare, por kujtimet nuk kanë pse të shuhen.

Për ta mbajrt lart emrin e Shoshit dhe shoshjanëve, unë nga emigrimi, kujtimet e mia nuk i mbajta të mbyllura, por unë mbolla ato, sadopak, me përkushtim në librin tim "Emigracioni", vëllim me poezi duke shpalosur ndienjat e mia të dashurisë për shoshjanët.E bëra Shoshin pjesë të librit, sepse Shoshi e meriton këtë dhuratë, pasi në kushtete e mia të vështira për të ushtruar punë atje, ata njerëz humanë, bujarë e fisnikë më dhanë strehim, ata më dhanë jetë, ata më dhanë mësim, ata më dhanë dije, ata më bënë pjestarë

familjeje,ata më shtruan bukën e ëmbël në tërvesat e tyre bujare e të nderueme me shpirtin e tyre njerëzorë.

Në raportet e mësipërme shoshjane ishin bashkëfshatarët e mi, shokët dhe miqtë e mi, prandaj dhe unë si i tillë jam përpjekë , sadopak, t'u shkruaj meritat reale të tyre në jetën gjithpërfshirëse të bazaar në të vertetën e kaluar dhe të sotme.

Për njerëzit, dhe kryesishtë djemtë e Shoshit ka nevojë shoqëria dhe gjithë Shqipëria, sepse ata janë pjesë e historisë së shkelqyer të shqiptarëve dhe malësorëve me vlera të paçmueshme.

Jam mirënjohës K/redaktorit dukagjinas Z.Lazër Kodra që më dha mundësinë që unë t'u përcjelli shoshjanëve mesazhin tim të përzemërt nëpërmes gazetës "DUKAGJINI".

Një falenderim i veçantë për Gjon Hilë Macorri, që me një vetëdije qytetare e njerëzore respekton bukën dukagjinase, respekton e ngulitë në kujtesë kohën që ka punuar në Shosh, madje e përjetëson atë në vëllimin poetik "EMIGRACIONI"- (L.Kodra)

GJON HILË MACORRI

## Mirënjohje për "Jehonën e Kelmëndit" nga Kuvendi Komunal Pejë, Kosovë

Rush DRAGU

Mirënjohja për Shoqatën Kulturore Artistike "Jehona e Kelmëndit" i është dorzuar kryetares së kesaj shoqate, Dila Vaçaj nga Kuvendi Komunal i Pejës, Kosovë në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, në Kelmënd të Malesisë së Madhe.

Në falenderimin e Mirënjohjes nga Kuvendi Komunal Pejë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Bashkësia Territoriale e Rugoves thuhet: "Për kontributin artistik në lojrat tradicionale të Rugoves" Kryetari i Kuvendit Komunal Pejë, Dr. Ali Berisha, Kuqishtë, me 4 gusht 2013.

Kuvendi Komunal i Pejës kishte zgjedhe pikrisht ditën e "Logut të Bjeshkeve-2013" në Qafe Predelec, në Kelmënd, në të cilin ishte i pranishem dhe Presidenti Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani për të dorzuar këtë mirënjohje për shoqatën e "Jehona e Kelmëndit" dhe po atë ditë një grup vajzash nga Plava, Gucia, Vuthaj dhe Rugova konkuruan në "Miss Bjeshka 2013", po ashtu dhe grupi artistik i Rugoves dha nje program të larmishën i gershetuar me lojra tradicionale popullore të Pejës, Rugoves, Plaves dhe Gucisë.

Historiku i shkurter i shoqatës "Jehona e Kelmëndit"

Shoqata Kulturore Artistike "Jehona e Kelmëndit" është krijuar në vitin 2006 me iniciativën e Dila Vaçaj. Në grupin nismetar për hartimin e statutit dhe programit të shoqates kanë qënë Kolë Leke Vushaj, Pjeter Dede Qosaj, Gjeke Ujka dhe Luigj Gjerka. Po atë vit është edhe akti i themelimit dhe vendimi i Gjykates së Rrethit Shkoder që ka njohur ligjerisht këtë shoqate.

"Jehona e Kelmëndit", ka qënë me shtatë anetar në grupin Folklorik të Qa-



Grupi i shoqates kulturore artistike "Jehona e Kelmëndit"

rkut të Shkodres, i cili ka marrë pjesë në Festivalin Folklorik Nacional të Gjirokastrës si kënetar, lahutar dhe valletar, dhe anetaret e kesaj shoqate kanë marre secili çmim në festival.

Ka marre pjesë në festivalin e Skenderajve të Drenices dhe merr çmim special për kostumet, vallen e kercimit malsorçe dhe në instrumentin tradicional të krahinës së Kelmëndit, lahuhtë.

Me arstin e 100 vjertorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë për krah 28 hapsirat shqiptare ka marrë pjesë edhe ansambli i "Jehones Kelmëndit" dhe ka marrë 6 çmime të para.

Po me rastin e 100 vjetorit ansambli i "Jehones se Kelmëndit" ka marrë pjesë në festivalin e Rozhajes dhe ka marre dy çmime të para.

Shoqata me iniciativën e drejteperdre-

jte te kryetares së saj, Dila Vaçaj ka organizuar koncertin tradicional të Krishtelindjes dhe Vitit të Ri për tre vite rresht të titulluar "Treversa e Kelmëndit"

Ka më shumë se 10 vjet që kjo shoqatë është organizatorja e aktivitetit tradicional të vitit "Logu i Bjeshkeve", i cili mbahet në një nga perlat e bukurise natyrore shqiptare, në Qafe Predelec të Kelmëndit.

Në këtë vit që përkon dhe me ardhjen për herë të parë të një kryetar shteti në krahinën e Kelmëndit, shoqata vlersohet dhe falenderohet nga Kuvendi Komunal i Pejës, komunë e cila është në administrimin e shtetit Kosovar, por përberja e të ciles është më së shumti nga kelmëndas.

Me rastin e dorzimit të mirënjohjes kryetares Dila Vaçaj, drejtues të Kuvendit Komunal të Pejës i bënë thirrje Presi-

dentit të Republikës së Shqipërisë që të ndikojnë tek shteti Shqiptar për të përshpejtuar punimet e Rruges Tamare-Guci, e cila kjo është veper madhore që krijon mundësinë e bashkimit fizik të shqiptarve.


Kush është Dila Vaçaj ?

Nga profesioni është mesuese, e cila ka sherbyer në shumë shkolla të zones së Kelmëndit. Është një nga vajzat e para malsorë në këtë krahinë që ka kontribuar në të gjitha aktivitetet kulturore me karakter zonal dhe nacional.

Është nje valletare e lindur dhe nje ko-reografe e zonja. Drejtuese e sukseshme artistike. Instrumentiste me shije te holla artistike. Një shoqe, bashkëshorte dhe nenë e mirë e tre femijeve.

# Një vepër e re e akademikut Aleksandër Stipçeviç për Arbëneshin (Arbanas) e Zarës (Kroaci)

OPINION NGA PROF. DR. SIMË GJON DOBRECI



Prof. Dr. Aleksandar Stipčević

Vitin e kaluar akademiku Aleksandër Stipçeviç botoi një libër të vëllimshëm "Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa" (Kultura tradicionale e Arbëneshëve të Zarës), Zagreb 2011, 425 faqe, të cilin po e përkthen shqip Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Fshatin Arbënesh (Arbanas), sot lagje periferike e Zarës (Zadar) në Kroaci, e themeluan malësorët shqiptarë prej katundeve shestanesë të Kranjës (krahine malore në jugperëndim të liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit, sot Mali i Zi). Nën mbikëqyrjen e arqipeshkvit Vicko Zmajeviq, prej 1726-1733, u shpërngulën nga këto anë, në valë të ndryshme, rreth 450 banorë, të cilët zunë vend afër Zarës (Zadrës) dhe krijuan fshatin Arbënesh (Arbanas). Ata shumë shpejt u shtuan: më 1853 ishin 900, 1868 – 1600, 1880 – 2000, 1893 rreth 2500, 1910 – 3087; shumica e bashkëshortëve kishin mbi 4-5 fëmijë, por jo rrallë edhe 15-20 e më tepër (në kohën ndërmjet dy luftërave botërore); disa familje kishin 50 e më shumë anëtarë. Më 1790 Arbëneshi kishte 74 shtëpi, 1810 – 164, 1880 – 326 dhe më 1900 – 384 shtëpi.

Duhet të kujtojmë që hapësira ndërmjet bjeshkës së Rumisë në Perëndim dhe liqenit të Shkodrës në Lindje, është, në kuptimin etnografik, njëra prej krahinave shqiptare më konservative të Ballkanit. Aty janë ruajtur besime të stërlashta të llirove paraantikë dhe antikë, por edhe ato të kohës së mëhershme paraindoeuropiane, prandaj nuk është e çuditshme që Arbëneshët e Zadrës prunë shumë elemente të kulturës tradicionale prej atdheut të moçëm, me të cilin nuk patën kurrfarë kontakti deri kah mbarimi i shekullit XIX. Ata i ruajtën doket e besimet ilire me mija vjet të moçme; është vërtetuar që shqiptarët janë popull autokton në Ballkan, mbasardhës të ilirëve. Në të gjitha veprimtaritë shoqërore Arbëneshët (Arbanasi) dhanë shumë personalitete me rëndësi jo vetëm për Kroacinë, por edhe për Botën. Në më se një pikëpamje Arbëneshët janë në kontekstin kroat më të rëndësishëm dhe më të njohur sesa janë në statistikën e përgjithshme kroate, vlerëson albano-

logu Radoslav Katiçiq, recensent i këtij libri. Me gjithë këtë, ata ishin ferrë në sy për regjimin komunist; nja 60 sish i vranë menjëherë mbas Luftës II Botërore. Arbëneshët e Arbanasit gjatë 2 shekujve të parë të jetesës afër Zadrës mbërritën të shqiptarizojnë (t'i bëjnë të flasin gjuhën shqipe) jo vetëm bashkëshortet, të cilat i ka sjellë martesat në Arbanas, por edhe krejt familjet kroate që zin vend në Arbanas. Ashtu krijohej deri diku një situatë paradoksale: në vend që Arbëneshët e ardhur të kroatizohen në atdheun e ri, ata shqiptarizuan edhe shumë banorë kroate, të cilët kishin ardhur dhe jetonin mes tyre.

Më 1870 (144 vjet mbas themelimit të Arbëneshit - Arbanasit) është shënuar: "Në familje flitet vetëm shqip, në këtë mënyrë ruhen traditat e moçme, kështu që fëmijët deri 7 vjeç flasin vetëm shqip. Më vonë mësojnë kroatisht dhe pak italisht." Mbiemrat: Pinçiq, Shestan, Gjergja, Deshpal, Nikpal, Paleka, Gjurlaka dhe toponimet e hidronimet si: Balta, Bregdeti, Fusha e Abëneshëve, Karma, Kisha e vogël, Kroni, Muri i madh, Pusi i madh, Shkambat, Vani bregdetit, Vani i kishës, si dhe emërtimet: Uvala Bregdeti, Skadarski prolaz, ul. Jurja Kastriotiça Skenderbega (rruga kryesore), ul. Fra Gjergja Fishte, Trg kraljice Teute flasin qartë që Arbanasit i nderuan dhe i nderojnë të parët e vet shqiptarë.

Arbëneshët e Zadrës ishin katolikë të vërtetë edhe në atdheun e moçëm, e po ashtu mbeten edhe mbasi erdhën në rrethin e Zadrës, por prapë se prapë nuk u liruan prej besimeve pagane të stërlashta, rrënjët e të cilave duhet të kërkohen në parahistorinë e largët.

Megjithëqë krejt afër qytetit të Zadrës, Arbëneshët ia mbërritën t'i ruajnë shumë doke e besime popullore të veta të stërlashta deri të Lufta I Botërore, e disa dhe deri në ditët e sotshme, siç janë: gjuha arbëneshë që e prunë prej katundeve shestanesë të Kranjës, mënyra patriarkale e jetës familjare, zakonet e fejesës dhe të martesës, lojërat e fëmijëve (grabitja e shamisë, bajrakut), nderimi i plakut të katundit, besa (Ja ko dhan besën), vëllamëria (pobratimija), fisi, veshja, surratat (maskenball, mashkare), dashuria për kubure (armë), vallja, nderimi i bukës, buzmi natën e Kërshëndellave, agjërimi (korizma), zakonet për pashkë, hedhja e gurit (me çit gurin), mjekësia popullore (ushunjëzat), besimi për gjarprin prej parahistorisë e deri sot (në katundet shestanesë të Kranjës: gjarpri në rrasë të vorrit, në mur të kishës, në mur të shtëpisë), besimi për zânat (emri zâna me prejardhje ballkanike e kohës ilire të stërlashtë; mali Zâna sipër Pinçit); të mos përmendet emri i drejt por eufemizmi (shestanasit: i mallkuemi); besimi për syrin e keq, hedhja e dhëmbëve

## KUSH ËSHTË PROF. DR. SIMË GJON DOBRECI?

Doktor Simë Gjon Dobreci i vitlindjes 1934, me profesion mjek, sot në pension, me banim në fshatin Braticë, në komunën e Ulqinit, është kryeredaktor i revistës "BUZUKU" dhe një nga drejtuesit e Shoqatës "Dom Gjon Buzuku".

E takova këto dite, në Braticë, na priti me shume kënaqësi e dashuri. E informova për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini" dhe gazetën e saj "Dukagjini", për 10 vjetorin e themelimit të saj, i dhurova dy numra gazete, diskutivim e 10 vjetorit, një stilolaps të përgatitur në ketë kuader. Ndjeu kënaqësi, shprehu simpatinë dhe dëshirën për të bashkëpunuar, të cilën ja premtova se, në të ardhmen do të bashkëpunojmë se, duhet të bashkëpunojmë.

Në ketë vizite isha me anëtarin e shoqates "Atdhetare-Dukagjini" Mark Kulla dhe Vate Gjoni. Shoferi yne ishte një djale simpatik, me banim në Itali, Arben Gjoni nga fshati Gjura. Në Ulqin u takuam me Zef Briskun, nje burra i gjate, rreth të 80-ve, shumë simpatik, gojatar, i pa lodhshem, i cili jo vetëm na bëri një shëtitje nëpër qytetin e bukur turistik bregdetar Ulqinin, na takojë me djalin e tij Leken me nip, por na siguroj dhe na shqëroi në takimin me prof. Dr. Sime Gjon Dobrecin. Bace Zefin e falenderojme për gatishmerine dhe kenqesine qe na dha!

Dr. Simë ishte një atdhetar i vërtetë, një intelektual i përkushtuar për çështjet atdhetare. Prandaj, në ketë numër gazete, po i botojmë ketë shkrim, të njërit prej albanologeve, siç është dhe prof. Dr. Aleksandar Stipčević, kroate, të përgatitur nga prof. Dr. Sime Gjon Dobreci. Ky emër dhe vendi i tij, na çojnë tek albanologu i madh, prof. Dr. Milan Shufflajn.

të tamblit sipër kulmit të shtëpisë; flijimi në themel të shtëpisë e një bagëtie ose të hollash metalike, mallkimet, kufomës i lihet në dorë një monedhë metalike (shestanasit i shtihet në gojë të vdekurit edhe sot një pare metalike). Të gjitha këto adete, besime janë gati të njëjta edhe ndër shestanasit.

Kur bën fjalë për disa doke e zakone, besime të kohës së stërlashtë paraindoeuropiane, Stipçeviç shkruan se pa marrë parasysh vjetërsinë e tyre të madhe, guxojmë të supozojmë që ato u bënë pjesë e kulturës ilire në kohën e bronzit e të hekurit, Ilirët i ruajtën, dhe ato vazhduan të qëndrojnë deri sot në mitologjinë e popujve të Ballkanit. Sidomos është e rëndësishme që popullit shqiptar në qenien e vet i ruajti shumë besime, magji e tjera elemente me prejardhje ilire, si dhe që disa prej atyre elementeve mbërritën rreth Zadrës falë Arbanasve. Stipçeviç ka mbledhur mjaft këngë, tregime, anekdota dhe fjalë të urta, por ai thotë që ato janë një mbetje e zbehtë e trashëgimisë së pasur të letërsisë, të cilën e prunë Arbëneshët e prej katundeve shestanesë. Qe pak shembuj: Këndon zogu, zog mullinja...; Atje larg ne fush të malit ... Atje me ta ko dek Skenderbeu; Ko ro pe kalit në gomarin, Kurkush nuk është le i suom.

Stipçeviç citon gazetën e vitit 1900: Nën at Arbanase u këndonin në gjuhën shqipe djemve në djep (përmbytja): "Nisu i gëzuar biri im i dashur, Atdheut tënd sot i duhen muskujt e tu. Mendo që kjo ditë është më fatlumja për nënën tënde, e cila parashikon të jesh ndër trimat e vërtetë të famshëm. Cila nënë nuk do ta parashohë fatin tim të mirë dhe të mos më konsiderojë të lume që kam kësi djalit. Por kujdesu biri im të sillësh mirë. Të mos i shmangesh fjalës që u ke dhënë shokëve të tu të armëve. Mos u tregoj pjellë e keqe e tyt eti, kurrë mos u tërhiq, lufto me guxim, kujdesu të jesh në radhë të parë. Kur do të me mbërrijë lajmi, që mbete në fushë të luftës bashkë me shokët e tu, unë do të vishem me të zeza, por prapë do të jem e kënaqur. Më mirë është mos të jesh nënë, se sa të kesh djalë të keq".

Stipçeviç na jep edhe një pjesë të fja-



limit të Juraj Biankinit, deputet në Këshillin mbretëror në Vjenë si dhe në Kuvendin dalmatin. Më 1896. ai ...u foli "Arbanasëve të Kroacisë për heroin e tyre Gjergj Kastriotin, si shembull i atdhetarit, trimit të patrembur në lufta për fe dhe liri të popullit vet"...

Përfundojmë me dy fjalë, Stipçeviç në librin e tij më të ri ka dëshmuar me fakte: Arbanasit e Zadrës i ruajtën vlerat kulturore dhe njerëzore të stërlashta të popullit shqiptar.

## Kush është Aleksandër Stipčević:

Historian i antikitetit, ilirolog, specialist i bibliotekarisë, akademik. Lindi në fshatin Arbënesh (Arbanas) të Zarës (Zadar, Kroaci) në një familje shqiptare. Kreu shkollën e mesme në vendlindje, ndoqi studimet e larta për arkeologji dhe u diplomua në Universitetin e Zagrebit (1954). Në v. 1957 filloi punën në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Zagrebit. Në fillim të v. '70 ka dhënë lëndën e arkeologjisë në Universitetin e Prishtinës. Drejtor i Bibliotekës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kroacisë në Zagreb (1974-1983). Mori gradën "Doktor" më 1977, një vit më pas fitoi dy tituj: "Këshilltar i lartë në bibliotekari" dhe "Këshilltar shkencor në fushën e shkencave shoqërore". Kryeredaktor i Lekikonit Biografik Kroat (1983-1987). U bë profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik (katedra e bibliotekarisë) të Universitetit të Zagrebit. Është autor i shumë studimeve në fushën e ilirologjisë, si: "Gli Iliriri", 1967 ("Ilirët"); "Arte degli Illiri", 1967 ("Arti i Ilirëve"); "Bibliographia Illyrica", 1967 ("Bibliografi për Ilirët"); "Kultni simboli kod Ilira" (1983), "Simbolet e kultit të ilirët"; "Problemi i vazhdimësisë iliroshqiptare dhe aktualizimi i tij politik sot" etj., si dhe në fushën e albanologjisë: "Interpretime albanologjike", "Etnogjeneza e shqiptarëve", "Albanologjia në Kroaci" etj.; gjithashtu ka botuar monografi: "Historia e librit" (1988), "O savršenom Censuru", 2003 ("Censori i përsosur") dhe qindra artikuj shkencorë. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. (Sipas "Fjalorit enciklopedik shqiptar").

# Thethi i "inisiativave", zhgënjimit e shpresës

Thethi është i njohur jo vetëm për bukuritë e ralla të natyrës, por edhe për cilësitë e vecanta të malësorëve të këtij fshati si bujarinë, urtësinë, dashurinë për vendin. Ata dalloheshin jo vetëm si bujq dhe blegtor, por edhe si ndërtues e përpunues të gurit e drurit, të nënprodukteve të qumështit, mishit e produkteve të tjera që merrnin nga blegtoja. Për bukuritë e këtij fshati, cilësitë e vecanta të banorëve të tij, pozitën gjeografike dhe gjithçka që ka qenë vlerë është shkruar dhe folur nga miq, dashamirë, vizitorë, vendas dhe të huaj vite e dekada me rall.

Thethi është vizituar që në vitet e para të shekullit të kaluar nga studiues, etnograf, gjeologë historian e të huaj, por dhe grupe të rinjsh nga qyteti i Shkodrës që shkonin në Theth për shëtitje ose për t'u ngjitur në male, të grupuar në shoqata të ndryshme që në Shkodër ishin të shumta dhe shumë planëshe.

Lidhja me rrugë automobilistike, hapja e shkollës fillore shtetërore dhe e konviktit, jo vetëm për të lehtësuar arsimimin e fëmijëve të zonës së Dukagjinit, por dhe të Nikaj- Mërturit. Vënja në funksion i një godine në qendër të fshatit për turizëm të organizuar, ndërtimi i një qëndre tregtare grumbullimi, ndërlidhje e të tjera të vecanta për zonë ndikoi, që ky fshat të njohe zhvillim më të avancuar se çdo fshat i Dukagjinit dhe më gjerë. Këto ndryshime tërhoqën më shumë vizitor, duke iu rritur interesi dhe vlera për këtë fshat.

Por në njohjen, ekspozimin, rritjen e vlerave të këtij fshati dhe komuniteti, rol të rëndësishëm ka luajtur kisha dhe misioni i saj, jo vetëm me predikimin e fesë, por dhe të edukimit, bashkëpunimit, pajtimit e të tjera. Aty në veanti të huajt kishin bazën e informacionit, sepse meshtarët që shërbyen në kishën e këtij fshati kishin arsimim perëndimor, kulturë dhe gjuhë, që çdo i huaj ndjehej komod me kushtet që i krijonte kisha. Kuptohet për vitet para çlirimit dhe pak vite pas çlirimit roli i kishës ishte i rëndësishëm.

Çlirimi i Shqipërisë Thethin e gjeti me komunitet me vlera dhe të grupuar në një fshat larg nga fshatrat e tjera të zonës. Këto cilësi ishin të përshtatshme dhe ishin studiuar nga sistemi e politika socialiste për të qenë model dhe bazë për "inisiativa revolucionare", duke e vënë në shërbim të propagandës, të shoqëruar me presion e shantazh, duke manipuluar vullnetit dhe realitetin e vetë malësorëve të këtij fshati.

Thethit i imponua "inisiativa vullnetare", për kolektivizimin dhe formimin e kooperatives bujqësore në vitin 1957, e para korporatë bujqësore në malësitë e mbishkodrës dhe ndër të parat në

shkallë vendin. Kolektivizimi i tokës dhe i gjësë së gjallë, u shoqërua me terror shtetëror, të drejtuar nga funksionarë të lartë të partisë, pushtetit dhe degës së punëve të brëndëshme të ardhur nga Shkodra.

Edhe pse presioni që i madh u deshën dy vite që të realizohej kolektivizimi në këtë fshat. Por çfarë ishte më qesharake?! Në Theth, gjatë kësaj fushate u shpallën dy kulak, njëri në fund të katundit, që mbante një tufë të vogël me dhi, e tjetri në krye të katundit, që mbante një tufë dele, që i mbanin me shumë vështirësi, sepse gjashtë muaj duhej ushqyer brenda në stallë nga dimri i gjatë.

Një "inisiativë" tjetër e orientuar të merrej nga kolektivi mësues, nxënës të shkollës 8-vjecare Theth, në vitin 1967 me objektivi "Ta bëjmë fshatin të pastër e të bardhë si bora e bjeshkëve, të rrisim fëmijët si pishat". Kjo "inisiative" pati jehonë në shkallë republike, dhe u

çdo kreveti ishte çarraniku, i ndërtuar me qellim për bulmet në veçanti për qumështin që hidhej në kopaja (korita). Çarraniku shërbente si një "frigorifer", për kushtet e atëherëshme, i cili kishte një formë të ndërtuar të vecantë, që sot do të ishte shumë interesante nëse do të ekzistonin. Që kullat të ishin të bardha, u shkatërruan krevetët, çarranikët, çdo gjë, që muret e shtëpive të zbuloheshin që të lyheshin me gëlqere të bardhë. Edhe dyerte e kateve të dyta, të cilat ishin me gurë të gdhendura, e shume prej tyre me harqe guri në pjesën e sipërme, që shpesh transportoheshin me krahë nga kilometra larg banesave. Edhe sot dallohen në muret e shtëpive trarët e prerë të krevetëve, shkallëve e çarranikëve që ishin në atë kohë. Ndërtimet e banesave të Thethit ishin në unitet me natyrën, të kombinuara aq bukur, sa rradhë kund do ti takoje. Çdo gjë për ndërtim ishte material nga guri e druri i fshatit, rëra, gëlqerja, trarët, dërrasat vetëm gozhdët

zhgënjimin dhe dëme të mëdha ndaj institucioneve, godinave publike dhe pasurisë së përbashkët, për të cilat ishte investuar vite me radhë. Këtë "nisëm çartistësh" që përbëhej nga pak individ, drejtohej nga njerëz që nuk ekspozoheshin por orientonin goja se po ndërrohen pushtetet prandaj dhe iu sulën objekteve, të cilat deri në atë kohë u kishin shërbyer të gjithëve. Ato mund të mos prisheshin e mos digjeshin, por të ndërrojnë funksion, e përsëri të jenë në shërbim të privatëve ose ndonjë grupi interesi.

Nga dora e shkatërrimit nuk shpëtuan as objektet e kishës. Nëse që nga viti 1967, kur u godit feja dhe institucionet fetare me vendime e nisma që tani dihen për Shqipërinë mbarë, në magazinën e kooperativës bujqësore u vendosën të gjitha ikonat dhe baza material e kishës së fshatit. Çdo herë që ndërroheshin magazinjerët, bashkë me bazën materiale të magazinës, merrej dhe jepej në dorëzim me shumë përgjegjësi objektet e kishës derisa kooperativa u shpërbë. Kur ikonat dhe baza tjetër materiale duhet të ktheheshin në kishë, kur kjo u kthye në funksionin e saj, në fillim të viteve 90-të, ato u vodhën u thyen e u shpërdoruan në mënyrë të papërgjegjshme. Bashkë me ikonat që ishin të vecanta dhe që kishin shpëtuar nga zjarri, që dogji dy herë kishën dekada më parë, u zhdukën dhe dy këmbanat, të cilat ishin shumë cilësore, jo vetëm nga funksioni, por dhe nga metali i tyre. Kemi parë sa me kosto, që tranzicioni te ne, por aty ku ka pak pasuri e pak njerëz siç ishte në atë kohë fshati, pasojat shihen e ndihen më shpejt e më lehtë, që riparohen apo ndërtohen më ngadalë, më vonë e me kosto më të lartë. Megjithatë jeta është luftë, ku shpresa, vullneti e dëshira për jetën duhet të jetë primare. Koha seleksionon të keqen, bashkë me mendimet e veprat e këqia duke triumfuar e mira dhe bashkëkohorja.

Thethjanët, janë kthyer dhe po kthehen, shumë nga ata që qenë larguar për në zonat urbane për një jetë më të mirë, të investojnë në fshatin e tyre, aty ku të parët jetuan, punuan e u ndanë nga kjo jetë vite e shekuj përpara. Tani ekonomia e tregut mundëson secilin të gjejë formën e tij të jetesës, mundësi investimi e të tjera Thethi po rilind me iniciativën e vetë thethjanëve. Ndryshimet po shihen si në turizëm, ndërtime të reja, rikonstruksione të shtëpive të vjetra dhe krijimi i mjediseve të përshtatshme jo vetëm për banorët, por edhe për ata që vizitojnë Thethin. Po përmirësohet infrastruktura, po rritet shpresa se, e ardhmja do të jetë më e mirë, më e bukur dhe më e sigurtë.

blieshin.

Megjithatë shteti i asaj kohe la disa shtëpi të vecanta, si dëshmi të akitekturës së ndërtimit të banesave në Theth. Disa prej tyre dhe i rikonstruktioi, duke i shpallur monumente të kulturës siç qenë Kulla e Zef Koçekut e cila u pakëzua si "Kulla e Ngujimit". Shtëpia e Lulash Keqit, përveçse monument kulture u shëndërrua në Muze Etnografik, me mjedise, paisje me gjithçka që ti shërbente qëllimit të njohjes të trashëgimisë historike, kulturore dhe etnografike të fshatit dhe zonës në përgjithësi. Nëse sot, po të ishte me ato paisje shumë tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, do të vlerësohej rëndësia e funksioni i tij dhe do rriteshin ende dhe më shumë vlerat e trashëgimisë së këtij fshati.

Një "inisiativë" tjetër që ajo e fillimit të viteve 90-të. Ajo, mbahet mend që solli



# LARG SYSH, POR QYTETAR NDERI NË ZEMRAT TONA

Para disa ditësh më ra në dore një vëllim me poezi me titull "Zemra prindërore", me shume autore-emigrante në SHBA nga të gjitha krahinat e vendit tone.

Ato krijime poetike të ngjallin emocione për ndjenjat e fuqishme të fëmijëve tanë, që i ruajnë për ne atje në emigrim. Zemra e tyre rreh fuqishëm për ne prindërit, vëllezërit, motrat, t' afërmit, për shokët e miqtë e tyre, për vendlindjen, për atdheun me moton "O sa mire me qene shqiptar!"

Në atë vëllim gjejmë vetveten, gjejmë ndjenjat e krijesave tona, për ne, për prindërit e tyre. Edhe pse aty nuk gjendet emri i djalit tim-emigrant tash 15 vjet në Angli. Ai, nuk bën poezi, por e bën biellen e motorit të "këndojë" edhe për mallin tone, për dashurinë për ne. Aty flasin djem e vajza shqiptare që jetojnë në SHBA aq bukur, me aq ndjenje të fuqishme, sa mua me duket se n' ato vargje është edhe zemra e shpirti i Ilirit tone të dashur. Mirënjohje atyre krijuesve, mirënjohje atyre që e botuan vëllimin për të biseduar me ne. Ai lexohet me një fryme. Ja se si shkruajnë ata/ato në parathënien e vëllimit: "Shpresojmë që vargjet e dala nga zemrat tona të miklojnë ëmbël zemrat e prindërve tanë duke iu dhënë një kënaqësi të veçantë që do t'ju zgjasë jetën."

Krijimet e tyre i motivojnë me dashurie për prindërit, e cila është dashuri për vete, është dashuria për tjetrin, është dashuria për Krijuesin, në fund të fundit është dashuria për jetën, thonë ata. Ja se si shprehet emigranti Belu Shaqo Arapi nga Përmeti nëpërmjet këtyre vargjeve: "Sikur mos të isha plakur / I mbytur me ngashërime / sedrën do ta kisha flakur / do qaja me ligjërime / ...". Gjek Marinaj, mallin për nënën, në poezinë e tij "Mall për nënën", e shpreh nëpërmjet këtyre vargjeve: "E mora gjithësinë në duar / të shuaj mallin e nënës / por kjo ndarje e tërbuar / qenka dhimbja e dhembjes / ...". Mallin për babën, nëpërmjet poezisë me titull "Për babën", Gjetu Turmalaj e shpreh me këto vargje: "Emri babe është nderim / emri babe është edhe stuhi / emri babe është bekim / emri babe është shëmbëlltyre / ..."

Mallin për nënën e shpreh bukur kosovarja Gjizede Isufi nëpërmjet këtyre vargjeve: "Nënëloke e dashur / sa shume qenke plakur / mungesa e fëmijëve / të paska djegur flake / ...".

Por, jo të gjithë emigrantet bëjnë poezi edhe pse mall e dashuri të madhe kane edhe ata/ato për njerëzit e tyre. Por, edhe ata kane gjetur mënyra e mjete të tjera komunikimi, nëpërmjet vizitave, nëpërmjet telefonatave, nëpërmjet videove, nëpërmjet internetit. Para ekranit ata/ato "ulen" shtruar si dikur në tryezën familjare duke uruar njeri-tjetrin me kafe, ose me gotën e rakisë apo të venës.

\*\*\*

Unë, në këtë rast dua të ndalem për njërin prej tyre, i veçantë për dashurinë e mallin që ka ai për njerëzit e tij, për miqtë e shokët, për dashamirësit e shumte që ka, me një shtrirje të gjere gjeografike nga Shqipëria e deri në SHBA, ku jeton prej shume vitesh dhe ky është biri i komunës së Shoshit, i mirënjohuri Ndue Ftoni.

Për këtë persona është folur e shkruar shume, një emigrant shume i suksesshëm në SHBA, duke u nisur nga hiçi, me punën e djersën e tij ka ngritur e funksionojnë tre biznese, me një menaxhim të admirueshëm nga ana e tij. Unë dëshiroj, që të portretizoj Ndue Ftonin në anën njerëzore të tij.

Ai, ka një dashuri të madhe për ata/ato që i mungojnë atje, njerëzit e tij, shokët, miqtë, dashamirësit e tij të shumte. E, ketë e shprehe jo vetëm me fjale, por kryesisht me vepra, me dashuri e mall, me sinjoretit e thjeshtësi, me përkushtim për vendlindjen, fshatin Ndreaj, për Shoshin e Dukagjinin, për Shkodrën e gjithë Shqipërinë. Takimet, bisedat me te, sa here që vjen në Shqipëri ai, i vlerëson të domosdoshme për te, prandaj nuk kursehet as në kohe e as në shpenzime. "Një kafe prej Ndue Ftonit!" pihet me kënaqësi e kjo "kafe" çdo vit po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha duke shtruar dreka e darka për qef-tin e gëzimin e tij, nëpërmjet të cilave shuan mallin me ata/ato që i done dhe e duan. Jam i bindur se nuk e teproj për të thënë, që Ndue Ftoni është një model i veçantë, pasqyre e një bote të pasur shpirtërore, e një zemre të madhe, e një bujarie të bujshme. Ai, sikur punon vetëm për të tjerët, për kënaqësinë e tyre.

Takimi me Ndue Ftonin është i këndshëm, madje i nevojshëm për secilin prej nesh. Ai, është njeri optimist, që e ka treguar me sfidat ndaj pengesave të dale përpara, duke filluar nga udhëtimi i pare pa para, pa mbështetje, pa orientim e mbi të gjitha pa ditur gjuhen e

huaj, por kishte bindjen se sakrificat e tij do të jepnin frutën e pjekur ashtu siç dhe fitoi brenda një kohe të shkurtër të behet një personalitet në SHBA.

Ndue Ftoni, nuk byrleket, nuk rrah gjoksin, nuk mburret, është i ekuilibruar, pa mllefe, i dhëne për ta lenë të kaluarën prapa e për të pare përpara se, vetëm kështu garantohet e ardhmja. Ai, ka fituar aftësi komunikimi, duke folur rrjedhshëm, qete, me kulture e edukate për jetën e tij, të familjes, të shoqërisë që ka krijuar jo vetëm me emigrantet shqiptare, por edhe me vendasit, me strukturat e pushtetit vendor, me senator, me intelektual, me diplomate deri në sferat e larta të shtetit amerikan. Me figurën e personalitetin e vet, ai ka fituar besimin e gjithë punonjësve, të cilët janë të punësuar në biznesin e tij. Ai, punon me ta, i done, i respektton, i trajton në baze të ligjeve të vendit, me të gjitha të drejtat e tyre. Për ketë arsye ata/ato mburren dhe e duan shume Ndue Ftonin.

Po të tjerët çfarë kane thënë për Ndue Ftonin? Vizitoret që kane shkuar n' Amerike janë pritur me dashamirësi të madhe nga Ndue Ftoni, duke u krijuar kushte për ditët e qëndrimit, për takime, vizita, konferenca, simpoziume e të tjera e të tjera. Dhe së fundi një përcjellje mbresëlënëse. Për këto vlera foli shkrimtari i mirënjohur Fadil Kraja, duke e quajtur krenari për Shkodrën, që bijtë e bijat e saj kudo që janë e përfaqësojnë me dinjitet atë. Po sa të tjerë flasin me pasion e sinjoretit te plote se, çdo shkodrane që të shkoje në Amerike do gjeje njeriun e vet, i cili është Ndue Ftoni.

Si edhe vitet e tjera, edhe ketë vit Ai, erdhi i gëzuar në vendin e vet, me u çmalle me familjaret, me shoke, me miq, me dashamirë e të tjerë. Një feste e vërtetë u shndërrua dreka e organizuar nga Ndue Ftoni në Bar-Restaurant "ORLANDO", pronar i secilës është një dukagjinasi, Tom Arra. Një pjesëmarrje e madhe, me dhjetëra e dhjetëra familjare, miq e shoke të Ndue Ftonit. Kjo feste ishte ndryshe nga herët e tjera, ishte për vëllain e tij, Mhillin, i cili vinte për here të pare në Shqipëri, pas 13 vitesh emigrim. Këto lloj pritjesh janë të radha, dhe si të tilla mbesin gjate në kujtesën tone, janë shume mbresëlënëse jo vetëm për Mhillin, Nojen, Vaten, Kolen e familjaret e tyre, por edhe për të gjithë ne, pjesëmarrësit në banketin e shtruar për ketë

rast. Gjithçka me shumice, por mbi të gjitha gëzim, hare, këngë, humor, kujtime, filmime, fotografi të shumta, vlerësime, dhënie titujsh e të tjera. Foli Ndue Ftoni, na uroi me zemër pjesëmarrjen duke na shtuar gëzimin e ardhjes së Mhillit, duke na uruar që ta kalojmë sa më mire si pjese e pandare e gëzimit të familjes së tyre. Pas tij, folëm edhe ne pjesëmarrësit, natyrisht jo të gjithë, por ne i uruam me gotën e rakisë dhe dikush me gotën e venës apo me shishen e berrës, i uruam për çdo vlerë që demonstrohej bujarisht në ketë pritje, me duartrokitje, me këngë e valle. Mirënjohjen tone e shprehu bukur, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja, shume bukur humorist e mirënjohur Gëzim Kruja e Rajmonda Marku edhe kënga e vallja që vijoje gjate gjithë pritjes, ishin shprehje e gëzimit dhe e urimeve tona. Kënduan bukur Preke Mrishaj, Ndue Shytani, Fran Kodra, Gofile Pappleka, Kole Hasani e të tjerë, valltari popullor Zef Lulashi, i veshur me kostum tradicionale të punuar me mjeshtri nga vete Zefi. Por, fjalët e mirënjohjes nuk u mbyllen këtu. E ka radhën Kryetari i Komunës së Shoshit, Mark Kulla, një djalë i ri, i gojës e i fjalës së mençur, i cili në emër të Këshillit të Komunës, bëri të njohur vendimin për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" të Komunës së Shoshit, birin e saj, Ndue Ftoni.

Me pas, një tjetër "djalë", Ndue Sanaj, kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", e mori fjalën dhe në emër të shoqatës, në mes të tjerave, falënderoj Ndue Ftonin për kontributin e tij për gjallërimin dhe krijimin e mundësive financiare në realizimin e misionit të kësaj shoqate, në veçanti duke mbështetur financiarisht botimin e gazetës "Dukagjini" nga 6-7 muaj për çdo vit, për përgatitjen e zhvillimin e veprimtarive artistike e kulturore, për botime librash të krijuesve dukagjinasi e të tjera. Për të gjitha këto, kryesia e shoqatës, në kuadrin e 10 vjetorit të themelimit të saj, i ka dhëne titullin "Nderi" i shoqatës.

Mire shkoje gjithçka. Mirësia e mbarësia, shpirti dhe zemra e emigrantëve, e djemve dhe vajzave tona të shpërndarë ane e mbanë botes, të mbajnë gjalle, t'i shtojnë e t'i çojnë më tej vlerat tona, ashtu siç i ka të shenjtë Ndue Ftoni, duke qene një biri shquar, një atdhetar!

Ndoc Grimaj

## EMIGRANTE NGA VILAJETI I SHKODRËS DHE I KOSOVËS NË PODGORICË ME 6 QERSHOR 1910

Në muajin qershor të vitit 1910, në Podgorice u krijua komiteti për kryengritje të armatosur kundër ushtrisë Turke, e për ti dale përballë egërsisë së Turkut Pashës, formojnë Komitetin e Podgorice, me këta anëtar, kryetar i të cilit zgjodhën Sokol Bacin nga Ksheva, duke ditur se ai është i lire tek Kral Nikolla dhe se ndihmat e armeve që u kërkohej nga Mali i Zi më lehte mund të merren me ndërmjetësimin e tij dhe djalit e Sokolit, Nikollen (Kolin) e zgjodhën sekretar.

Komiteti i Podgoricës përbëhej: Sokol Baci (kryetar), Nikolla, Koli (sekretar), Ded Gjon Luli, Nike Gjelosh Luli, Tome Zoli me vëlla Lenken, Gjon Nike Plluci, Gjeke Marash Gjeloshi, Kol Marash Vata, Luç Muç Elezi, Mehmet

Shpendi i Shalës.

**Anetar te komitetit nga Shkodra:** Luigj Gurakuqi, Hile Mosi, Risto Siliqi, Ndreke Kici, Shane Koliqi, Pjeter Bumçi, Gjon Cini, Nush Koçi, Loro Suma, Pashko Troshani, Zef Dema, Simoni i Gjon Laces, Ndoc Shoshi.

**Ndihmesa te ketij komiteti:** Lush e Ndoc Guga, Ndoc Naraçi, Pjeter Kici, Kel Shan Shoshi.

**Dege të ketij komiteti vepruan në Rijek:** Mati Koliqi, Mati Stani, Gjon Mala vëllai i Gasperit, Mark Ndoja.

**Në Cetinë:** Zef Koka me vëllezërit, Ndoc Koliqi me vëllezërit, Zef Jak Dajçi.

**Në Virpazar:** Nush Guli e Jak Deda.

**Dezertor nga ushtria në Podgorice:** Nga njësi ushtarake në Guci dezertojnë 27 ushtarake dhe nga ajo e Plavës 6 vete.

**Nga Vilajeti i Shkodrës emigrante në Podgorice:** Shala 75 vete, Gruda 74 vete, Hoti 88 vete, Kastrati 19 vete, Rrjollli 3 vete, Reçi 14 vete, me vone edhe 161 vete nga krahinat e Dukagjinit, prej tyre ka pasur gra dhe fëmijë, si: Çuk Delia me familje, Çuk Delia e shoqja, Kaje Keqja me fëmijë, Martin Çuku, Drane Çukja e Sile Çukja nga fshati Gimaj, Zoj Lulja, Kaj Stakja, Mac Sokolja, Raz Çunja e Lul Martinja.

Dr. Zekria Cana, nga Kosova, shkruan: Këta

emra u botuan në revistën "Koha" nr. I, II ne vitin 1911. Ne Cetinë u krijua këshilli me në krye Serdar Pavaviçin. Për mbledhjen e ndihmave vullnetare, në qytet u krijua këshilli për bashkimin e ndihmave. Emrat e ndihmave shënoheshin në lista të veçanta dhe botoheshin rregullisht në organin vjesnik. Deri ne vitin 191: **Emigrantet nga Vilajeti i Kosovës** merrnin si ndihma nga 3 perper në dite, ata të vilajetit të Shkodrës sipas anëtareve të familjeve 100, 150, 200 deri në 300 perper në muaj, ndërsa të gjithë të tjerët që kishin kaluar në Mal të Zi, për ti shpëtuar rekrutimit në ushtrinë turke prej 2-3 perper në dite. Nga 14 Shkurti i po atij viti, Ministria e Brendshme urdhëroi: Ndihmat në të holla të jepen sipas këtyre kriterëve: Emigrantëve nga vilajeti i Kosovës që kishin ikur nga shkaku i gjendjes tmerrshme me Turqi dhe ishin vendosur në Podgorice, Nikshiq dhe Cetin t'u jepej nga 3 perper në dite, me përjashtim të disa krerëve të njohur; ndërsa atyre që ishin strehuar në Mal të Zi për veprimtari krimi ose vjedhje dhe ikje nga burgjet i shkëputej plotësisht ndihma materiale.

**Emigrantëve nga vilajeti i Shkodrës** të vendosur në Podgorice do t'u jepej edhe më shume sipas numrit të anëtareve të familjeve. Ata që ishin dezertor nga vilajeti i

Kosovës, sapo gjenin pune krahu menjëherë u shkëputej ndihma materiale. Ata që jetonin me pune krahu ishin në gjendje shume të vështirë ekonomike. Pas qëndrimit të Valiut të Shkodrës, Bedri Pashes në Cetinë dhe bisedoi me autoritetet malazeze dhe te tjerë për çështjen e refugjateve, qeveria malazeze kërkoi nga ata, refugjatet t'i bindeshin vullnetit të Sulltanit dhe të ktheheshin në shtëpitë e veta. Kështu, që mbi 1000 malësor u larguan nga Mali i Zi. Mirëpo me tu kthyer, filloi kryengritja e Malësisë së Shkodrës kundër ushtrisë turke. Në vitin 1911, populli i kësaj ane rishtas u kthyen në emigrim. Me urdhrin e qeverise u vendos që kjo popullate sa më pare të largohet larg nga kufiri Turko-Malazez, që mos të komunikojnë me kryengritësit. Në arkivin e Malit të Zi, Cetinë ruhen listat e refugjateve shqiptar sipas vilajeteve.

(Marre nga Dr. Zekria Cana, Arkivi Cer-rngore (Arkivi i Malit të Zi), Ministria e Punëve të Brendshme, faqe 2088, shkresë e Ministrisë së Brendshme, me nr. 1294 date 07 / 06 / 1910, faqe 101, 2225, shkresë e Ministrisë së Jashtme, me nr. 11891, date 15 / 06 / 1910).

Zef Nik Krypçi

# Jehona e festës së 10 vjetorit të themelimit të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, vijon ...



OPINION nga Daniela Pjetri

10 vite jete “Shoqata Atdhetare Dukagjini” Festuam 10 vetorin e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini!!!...- kjo datëlindje e 10 vjetorit të krijimit të shoqatës mund të themi me plot gojën se, ishte diçka e veçante! Fillimisht ne, pame një koncert me shume ngjyre, me këngë e valle të larmishme, me dekoracione të shumta në adrese të atyre njerëzve, të cilët dhanë një kontribut të çmuar gjithë këto vite për dukagjinasi, në ruajtjen promovimin dhe shpalosjen e vlerave e të traditave të dukagjinaseve ... janë vlera

virtute e zakone të dukagjinaseve të gjalla dhe sot ... gjithë këto vite shoqata “Atdhetare-Dukagjini” ka bere një punë të jashtëzakonshme, që këto tradita të bukura të dukagjinaseve të ruhen e të eksploroohen duke ecur paralelisht me kohën ... E kemi pare dhe te pjesa e dyte e festes gjate paradës së nuseve me vela ... si tek të rinjtë që ishin me kostumet e vjetra popullore e me xhubletë ... pikërisht aty pame një ndërthurje të veshjes dhe krejt pamjes së nuses tradicionale dhe asaj moderne! Ishte me të vërtet diçka e papërshkrueshme ... diçka që për të qenë të sinqerte ishte pare radhe ose aspak neper skenat shqiptare ... edhe fytyrat e të pranishmeve i përshkonte një njësi kënaqësie dhe krenarie ..., të cilët e shprehnin të gjithë admirimin e tyre përmes duartrokitjeve të njëpasnjëshme! Ishte një feste 10-vjetori, mjaft e bukur, me të vërtet një dite për të mos u harruar!



Kur ti më përcillje,  
N’udhëtim unë me dalë,  
Në detin e trazuar,  
Plot furtunë e dallgë.

Buonvaxho!- më thoshje,  
Kthehu sa më shpejt,  
Krahëhapur ty të pres,  
Bashkë të ecim në jetë.

Kujtimet më risollën,  
Atë moshën e rinisë,  
Me dhimbje e nostalgji,  
Humbjen e dashurisë.

## MOSHA E RINISË

Ajo pranverë e bukur,  
Plot lule për ty kish çelë,  
Se dhe ti vetë ishe  
Një lule plot erë

Pranvera përsëri erdhi,  
Shiu akoma s’ka pushu,  
Ky shi mua më duket,  
Si lotët në sytë e tu.

poezi nga NDUE MICI

## Komuna e Kelmëndit “Nderi i Kombit”

Rush DRAGU

Në një atmosfere festive, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani ditën e shtunë, me 9 gusht 2013 i ka dorëzuar dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” për Kelmëndin, kryetarin të komunes Kelmënd Ing. Gjeto Dakaj, me motivacion: “Për kontribut të shquar për identitet kombëtar, për trimëri dhe heroizëm në kryengritjet antiosmane për pavarësi, për qëndrueshmëri heroike në ruajtjen e kufijve kombëtarë nga copëtimi shovinist, për kryengritjen e parë antikomuniste (1945), ku gjaku i martirëve



Presidenti i R.SH, Bujar Nishani, duke i dorëzuar kryetarit të Komunes inxh Gjeto Dakaj, urdhrin e lartë “Nderi i Kombit”, për kete komune

u shndërrua në memorie dhe vullnet për të kërkuar demokraci, për prijësit dhe bijtë e saj të shquar që ka nxjerrë në shekuj”


Presidenti i Republikës arriti në Kelmëndin i shoqeruar nga Prof. Gjokë Uldedaj, Paulina Hoti, Ramiz Cobaj, deputeti i Malësisë së Madhe Gjovalin Bzheta, ish kryetari i komunes Badhdre në Rrethin e Lezhes dhe nenkryetari i Qarkut Lezhe, Gjovalin Gjeloshi (kelmëndas), kryetari i komunes Bushat Zef Hila.

Pas një fjalë mirëseardhje për Presidentin Nishani nga kryetari i komunes Kelmënd, ixhnier Gjeto Du-

kaj, e mori fjalën Presidenti, i cili revokoj pjesë nga historia e lavdishme e Kelmëndit në veçanti, por edhe e Malësisë së Madhe në përgjithësi dhe në fund dorëzoi dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” për komunen e Kelmëndit.

Gjithashtu në këtë ceremoni u be i njohur se, Baletmaestro me fame botrore, Angjelin Prelocaj është dekoruar me urdhrin e lartë “Nderi i Kombit”, e cila do t’i dorzohet artistit në presidencë.

Duhet theksuar se në këtë ditë feste kishte shume pjesëmarrës nga Komuna e Pejes-Kosove, komuna Plave-Guci, nga Vuthajt po ashtu ishin të shumte dhe malësoret nga Hoti, Gruda dhe Trieshi.



## VITRINA E LIBRIT

REDAKSIA  
Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Lazër Stani,  
Roza Pjetri, Prelë Milani,  
Luigj Shyti, Suela Ndoja,  
Zef Nika, Zef Gjeto, Lulash  
Brigja